BEGZAT RRAHMANI
QEFINARËT

Begzat RRAHMANI

QEFINARËT

Feniks – Kërçovë

Biblioteka: Shtiaku

Redaktor: Dr.Ullog Rumdumi

Recensentë: Dr.Trur Sterili
Dr. Savan Sallxhiu

Lektor: Dr.Kastraveci

Rradhitja kompjutoristike: Argjend B.

Ballina: Rijad Bajrami

Shtëpia botuese “FENIKS” – Kërçovë

Dr. FILIZA

Biti ndërpreu mardhënien e punës, në shkollën fill ore të fshatit për të vazhduar studimet në Fakultetin Pedagogjik-cikli i ulët.

Bitit jo vetëm që i shkonin mirë studimet, por ai u kyç edhe në strukturat politike të Fakultetit. Shumë here prindërit, fshatarët dhe shumë të njohur Bitin e shikonin në emisione të natures edukative, por edhe të assay politike. Më vonë u bë antar i Partisë Opozitare në Kryeqytet, por edhe Pozita disa herë i kishte afruar disa poste, por për Bitin primare ishin provimet dhe si antar i Partisë Opozitare ishte më i rehatuar.

Pas disa muajsh Partia e angazhoi, që të mirrte pjesë në një duel televiziv me një apo më tepër antarë të Pozitës. Ky duel do të emitohej prej televizionit shtetëror, që mbulon tërë hapsirën shqiptare bile edhe më gjërë. Sipas organizatorëve ky duel duhej të ishte një duel mjaftë i nxehtë politik. Pasi u bënë të gjithë përgatitjet, një natë fiks në ora 21 në ekranin e televizorit shkruante -DUELI SHUMË I PRITUR-

Gjatë tërë debatit përfaqësuesit e Partive Politike ishin mjaft korrekt, tamam si akademikë të ardhshëm, edhe pse kjo sjellje e tyre nuk i pëlqente udhëheqësit të emisionit, por as edhe shumë shikuesve! Nëna e Bitit pasi e shikoi gjysmën e duelit i tha të shoqit:

-Sa do të isha e lumtur, që kjo vajzë të bëhet nuse e shtëpisë sonë!- burri duke qeshur i thotë:

-Hesht moj grua, ti nuk i kupton punët e politikës, ata janë kundërshtar e ti thua të bëhet nuse e shtëpisë sonë!

Pas debatit Biti e thirri në kafe, por duke i kërkuar falje, pasi gjatë tërë kohës që ishin në studio, nuk arriti t' ia mësonte emrin. Vajza me shumë kënaqësi e pranoi ofertën dhe poashtu me shumë kënaqësi i tha se emri i saj ishte Filiza, por shkurt i thonë File. Atëherë Biti ia shtriri dorën duke i thënë se emri i tij është, por Filja e ndërpreu duke i thënë se emri i tij është Biti. Ashtu duke biseduar hyrën në lokalin e parë që ndodhej në afërsi të televizionit.

Prej asaj nate takimet e tyre ishin më të shpeshta dhe më të ngrohta, edhe pse u takonin partive të ndryshme. Ndoshta këto takime ishin shkaku që Biti filloi ti rrallonte udhëtimet e vikendeve për në fshat.

Biti pasi morri një frymë, e hapi valixhen dhe filloi ti paltonte teshat e lara dhe të hekurosura tamam si tesha qyteti, pastaj e hapi një qeskë najlloni, ku e ëma i kishte futur burekun që ai e deshte shumë, prandaj edhe e quante si specialitet. Ai morri disa kafshata, por kur iu kujtua se e ëma i kishte thënë; po ta kishte afër atë vajzën e televizionit i jep një copë prej meje si shëndet katundareje. Biti duke qeshur i kishte thënë:

-Nënë aq shumë të ka pëlqyer ajo vajzë?ajo i përgjigjet:

-shumë bir i nënës,shumë, por kam frikë mos të

jetë e fejuar! Biti thotë:

-Po të jetë e fejuar nënë?! Nëna si me gojë të huaj thotë:

-Atëherë le ta ketë fatin e mirë Bito…

Biti pasi bëri një dush e rregulloi pak dhomën dhe e thirri Filen më telefon, duke menduar se edhe ajo më duhej të kishte mbërritur. Sa ra telefoni Filja e kapi receptorin.

-Alo File, o më falë që s' thash doktor File, do të ishte mirë të vinit sontë te unë, pas cimeri më ka lënë një pusullë, se s' do të vijë sonte. Filja ia ktheu:

-Mirë zotëri Profesor, pas një ore do të jem te ti.

Edhe Filja si Biti dallohej në grupin e Medicinës. Asaj për afatin e shtatorit do ti ngelin edhe dy provime, kurse Bitit edhe tre, prandaj ata në qershor kishin bërë shkëmbimin e unazave dhe lajmëruan edhe prindërit duke i thirrur në kafe edhe ate te banesa e Bitit, që të hapej rruga që pushimet verore ti kalonin herë te njëri herë te tjetri.

Filja herën e parë kur vajti në fshat te Biti nënës së tij i tha:

-Kam ardhur me një dëshirë, nesër për drekë të na bësh prej atij specialitetit të Juaj, pasi ne në qytet se kemi në menynë tonë. Nëna e Bitit u mendua, por asesi të kujtohet për çfarë specialiteti bëhej fjalë. Filja

ia sqaroi me ca fjalë dhe më në fund, ajo qeshi, pasi iu kujtua se bëhej fjalë për njëfarë bureku.

Të nesërmen nëna e Bitit ndihej tamam si vjehërr dhe e lehtë si flutur. Ajo duke e pjekur kafen e mëngjesit, Filja hyri në derën e guzhinës. Vjehërra së pari ia afroi një kupë dheu plotë me mjaltë, të cilin babai i Bitit e kishte nxjerrur prej një koshereje. Filija me shumë vështirësi e hëngri një majë luge, por vjehërra nja katër a pesë lugë të plota. Pastaj e pinë edhe kafen, vjehërra prapë ia afroi mjaltën, por Filija u përprish në fytyrë duke i thënë se u gërdita, e mori kafenë e Bitit dhe doli për dere.

Biti e kishte marrë pakon e cigareve dhe me padurim pritte kafenë. Filija ia dha kafenë, kurse Biti i tha të ndizte një cigare, por Filja e rrefuzoi, dhe ashtu filluan një bisedë rasti. Pas pak Filja u afrua te dritarja duke parë një mollë plot fruta. Dhe pastaj e lëshoi shikimin më larg ku e pa nënën e Bitit duke kositur barin dhe pastaj e mbushi një kosh e vuri në shpinë u drejtua kah stalla e lopëve që i ushqenin në grazhd. Nëna i bënte punët, kurse Filja me Bitin bisedonin: për fshatin, të rinjët e fshatit, shkollimin e tyre dhe më në fund edhe për ambullancën e fshatit.

Nëna e Bitit pasi bëri ushqimin e lopëve, në një shportë mblodhi ca vezë të freskëta dhe u kthye në guzhinë, ku qumshti i vluar akoma avullonte. Mbi tavolinë vëndoi edhe tri gota të kristalta një enë të mbushur me sheqer dhe atë kupën me mjaltë. Afër

shporetit afroi vezët dhe një fëltere vëndoi një copë bukur të madh të tëlynit të lopëve.

Filja sa e hapi derën e ndiu erën e groshës që më kishte filluar të vlonte, për specialitetin e porositur. Nëna e Bitit i tha se mëngjezi është gati vetëm sa ti skuqi ca vezë, se ai specialiteti që aq shumë e doni ju do bëhet më vonë, e gjer atëherë s' durohet. Filja i tha se ajo nuk do gjë të fusi në gojë gjerë sa të bëhet bureku, por besoj tha se edhe Biti, pasi më tha se kur të bëhet gati atëherë edhe ai do të çohet. Mirë tha nëna e Bitit pasi ju nuk doni unë do të bëj sa për mua. E afroi atë fëlteren te shporeti, dhe Files ia mbushi një gotë me qumësht dhe ca lugë mjaltë duke i thënë se ti je e re duhet të hash më tepër. Unë kur kam qenë e re si ti kam hëngër tri herë më shumë se që ha tash. Ama në arë kam qenë e para ndër gra. Shatin tim vjehërri ma porositëte te Temur kovaçi. Gjersa i bëri këto fjalë edhe tëlyni ishte bërë për të lëshuar vezët. E afroi shportën e vezëve dhe filloi ti thyente. Një, dy, tri… gjashtë. Atëherë Filija edhe njëherë i tha:

-Unë Ju thash se nuk do të hamë gjersa të bëhet bureku, bile as gotën e qumështit nuk mundem ta pijë. Atëherë vjehërra i tha:

-Unë kuptova se ju nuk do të hani, prandaj i theva vetëm gjashtë vezë. Ndërsa Files i ishin përzier erërat e groshës, tëlynit, dhe fjalët e vjehrrës, vjehërra në tavolinë vëndoi edhe një gjysëm buke, një copë djathë, që ndoshta Filja ato do ti hante tre ose katër

ditë. Vjehërra e mbushi edhe një gotë qumësht dhe i futi edhe tri lugë mjaltë. E nxorri fëlteren prej shporeti dhe i tha Files që ti vëndonte edhe asaj ca në një pjatë, por ajo e rrefuzoi kategorisht. Atëherë vjehërra i vëndoi në një enë dhe ua hodhi edhe tëlynin sipër. Vjehërra me shumë oreks filloi të hante, kurse Filja doli, që ti tregonte Bitit, por ai flinte si ndonjë qengj. Doli në oborr, por s' ndejti shumë pasi dielli kishte filluar të nxehte. Kur hyri në guzhinë pa se vjehërra ishte kah fundi, pa si ajo me një copë buke e fshinte enën ku pak më parë kishte jo më pak se gjashtë vezë. Pastaj e piu edhe gotën e qumështit. Atëherë Filja e pyeti si qëndronte me shtypjen, a ka kokë dhembje, apo marramendje? Ajo i tha:

-Unë s' di çka më pyet ti. Këto fjalë ka njëherë i thotë babi i Bitit. Kurse unë nuk jam pulë që të mirren mendët.

Specialitetin e hëngrën edhe ate me kos delesh, bile Filja pak e teproi duke mos menduar për shtypjen, dhe marramendjen.

Duke lënë anësh politikën Biti dhe Filja kah fundi i vjeshtës ndodheshin në shkollën dhe ambullancën e fshatit…

HAXHI “PROF”TEOLOG IMAM EFENDI EL RUMDUM

Për leximin e MEVLUDIT TË VOGËL ishin mbledhur mbi dy sofërr burra intelektuala me nam, por kishte edhe të tjerë, bile edhe një çerekintelektual. Pas pak në derë u paraqit edhe IMAMI i Xhamisë së Madhe, një “INTELEKTUAL” më i lart në titull. Ky farë imami dallohet jo veç me vaiz më siç ti vi në mend, por edhe si shkencëtar.

Sa u ul dha dhe morri selam, prej atyre intelektualëve, pa se atmosfera ishte e përshtatshme, sipas do porosive, që janë thënë më parë, pa humbur kohë ia filloi vaizit:

-Të nderuar burra myslimanë, siç dhash unë të jepni edhe Ju selam. Kurrë dhe kurkund mos e përdorni-MIRË DITA, pastaj LAVDI dhe kurrë mos vëndoni shenjë në varret ku janë të varrosur SHQIPTARËT MYSLIMANË. Mëkate më të mëdhaja se këta që thash nuk ka në botë tjetër. Disa intelektual pohonin me kokë e ca të tjerë bile ia filluan të qajnë. Ca çoheshin shkonin afër hoxhës dhe i futnin diçka në xhep, atëherë ai merrte hov më të madh.

Këtë HAOS-FENOMEN e prishi një çerekintelektual kur i tha: ç’folë bre hoxhë,por një intelektual i tha, që të heshti se ai nuk dinë gjë dhe se

nuk e paska vendin në mesin e tyre. Atëherë hoxha ia filloi pak me më shumë revolltë:

-Kështu njerëz si ju janë edhe kundër Universitetit në gjuhën shqipe!- atëherë çerekintelektualët i tha:

-Po ne jemi kundër në gjuhën maqedone dhe sipas teje në gjuhën arabe, por ju edhe në gjuhën e pastër shqipe. Ti njëlloj si maqedonët vepron në këtë mes…???!!!

Pasi u këndua Mevludi e hëngrën edhe darkën, duke u përshëndetur njëri i thotë çerekintelektualit:

-Mirë ia bëre hoxhës…???!!!- ai ia ktheu

-Unë mirë ia bëra hoxhës me fakte, por ti mirë ma bëre përpara hoxhës pa fakte.- kush dinë se ku do të dilte kjo bisedë, po të mos e kishte ndërprerë një Taxi i cili u ndal aty afër dhe prej tij doli një femër. Ajo e hapi derën dhe në të u fut një haxhi. Dikush tha se mirë e paska bërë regjinë haxhiu për të rritur autoritetin…???!!!

SHKATËRRIMI I NATO-s

Në mbledhjen e fundit që u mbajtë në Moskë, një funksionar i lart maqedonas tha:

Atë që s' arriti ta bëjë vëllau i ynë-SERB, kemi shans ta bëjmë ne, pasi Amerika ndodhet në krizë, prej SHERRIT-KAURR. Pra s' pari ta SHKATËRROJMË NATO-n, pastaj do ta kemi lehtë me SHQIPTARËT…???!!!

VAJZA E KEQE

Sa zbriti prej aeroplanit Z. Perdju një gazetarë e pyeti:

-Z. Perdju, Ju lutemi çfarë do të na thoni për Parlamentarët Maqedonë dhe për Referendumin e Preambulës? ai përgjigjet:

-Maqedonasit, më falni Sllavomaqedonët janë të pa parashikueshëm ose më mirë të them si ajo vajza e keqe, por mos mendonin në Monikën, që përherë thotë ne do të kënaqemi, por nëse pendohem unë do të them se më kanë detyruar, por ndoshta do të them se më kanë dhunuar…???!!!

ABC-ja E POLITIKËS

Një grupë pleqsh, së bashku me imamin e fshatit, aty në oborr të xhamisë pritnin kohën që të falnin namazin e drekës. Pasi gati të tërë treguan nga ndonjë ndodhi, më në fund u zhytën në punët e politikës.

Njëri nga pleqtë e pyeti hoxhën për këta të huajt që vinë në Maqedoni, si psh. z. Frovik, z. Perdju, z. Leotar dhe z. Robertson? Hoxha dha mendimin e vet, pastaj edhe shumë të tjerë. Pa mos e mbaruar bisedën erdhi edhe xha Biti. Ai i cili e pyeti hoxhën, ia sqaroi pyetjen edhe xha Bitit dhe më në fund kërkoi edhe mendimin e tij. Xha Biti pasi u mendua pak bëri disa shenja me dorë e me kokë, ashtu siç e ka shprehi, ia filloi:

-Ju gati të tërë jeni moshatarët e mi, prandaj besoj se mirë e mbani ndërmend kohën ku prej Shqipërie vinin MËSUES dhe MËSUESE të na mësonin ALFABETIN. Tash ata që i përmendët Ju, vijnë për këta politikanët, që t' ua mësojnë ABC-në e POLITIKËS. Ndoshta xha Biti do të thoshte edhe më tepër, por hoxha i thirri për namaz…!

BOJKOTIMI

Nxënësit maqedon në gjimnazin e Kumanovës, paskan BOJKOTUAR mësimin duke thënë se ata nuk janë të barabartë me nxënësit SHQIPTARË. Ju lumtë pasi më në fund edhe ata janë vetëdijësuar, edhe plotësisht ata kanë të drejtë në bojkot.

Shqiptarët mësojnë gjuhën, sllavomaqedone, kulturën dhe historinë e tyre, kurse sllavomaqedonët s' dinë kurgjë për shqiptarët…???!!!

ABETARJA

Z. Novkovski Ministër i Arsimit, këto ditë kuptoi se Shqiptarët paskan përgatitur një ABETARE për tërë Kombin. Pa humbur kohë dha urdhër që prej "shqiptarëve të ndershëm" të sigurohen të tëra Abetaret që janë përdorur në këto troje prej pas L.N.Ç. Pas shumë debatesh dha urdhër që të përgatitet një kundër Abetare për tërë kombin shqipëtar. Risi do të ketë që në ballinë dhe në çdo faqe të shkruhet: AGIMI DO TË RUAJE SHQERRAT. ZORANI DO TË SHKOJË NË SHKOLLË.

Duke u uruar punë të mbarë u tha se mjetet për suksese janë të pa kufizuara. Ashtu prej koke hoqi atë barrë të rëndë…???!!!

QEFINARËT

Këto ditë në qytetin e Kërçovës u themelua shoqata “QEFINARËT”. Pas shumë sugjerimesh, nuk munguan as bisedimet e nxehta sidomos ata rreth pamjes së FLAMURIT të kësaj shoqate e cila është UNIKATE në tërë botën…?!

Por më në fund erdhën në një ujdi më si Qefinarët. Vendosën që në copë QEFINI të bardhë-HASE, në të katërt skajet të vendosen katër KRYQE, që njëri nga tjetri të dallojnë shumë, shumë pak. Pasi ky është një shtet ORTODOKS, por dihet mirë SLLAV! Në mes të FLAMURIT të vendoset SORRA, por një SORRË unikate, vetëm ata e dinë se kush mundet të jetë ajo SORRË. Në vendin e propozuar të Yllit, vendosën të qëndrojnë HËNA, pasi të tërë QEFINARËT janë të fesë ISLAME…?!

Për KRYETARË u zgjodh personi i cili dhjetë ditët e fundit nga dy orë në ditë, atëherë kur falet NAMAZI I MESDITËS qëndron i shtrirë në TABUT i cili është i mbuluar me FLAMUR. Tabuti qëndron mbi një tavolinë, pasi TENESHIRIN nuk ua kanë dhënë, dhe gjersa të sigurojnë mjete materiale, për një TENESHIR-UNIKAT.

Gjatë asaj kohe bëhen HOMAZHE, bile disa duke qarë vendojnë edhe kurora. Mbrenda në Tabut së bashku me KRYEQEFINARIN ndodhet edhe një

aparaturë shumë e përsosur për incizimin e bisedave. Pasi kalon koha e Homazhit, KRYEQEFINARIN e marrin me veturë speciale për të vdekur dhe e dërgojnë në Qendrën e Policisë për INFORMATA…???!!!

GJAKPIRËSIT

Dikur thoshte Titoja se rreth tij ka shumë BUDALLENJ, por atëherë Titon se besonte bota. Pas vdekjes u bindën bota, jo vetëm për budallenjt, por edhe për GJAKPIRËSAT…???!!!

ZHVESHJA

Të mjerët janë ata njerëz që ZHVISHEN prej KOMBËTARES, por edhe prej FETARES, për tu ngopur si DERRA e për tu veshur si LARO-PUSHTA?!

VENDI I PUNËS

Ata që mundohen rrugëve të tregojnë DREJTËSINË dhe DIJENINË e vet, kurrë si gjenë në

vendin e punës, por nëse i takon në vendin e punës aty s' të folin as për DREJTËSI e as për DIJENI…???!!!

OSAMA BIN LADEN

Prej burimit tepër sekret kuptuam se Osama bin Ladenit, këto ditë iu dha AZIL politik në një shtetm të vogël ORTODOKS. Tash për tash është sekret, por dihet, se Osama bin Ladeni është vendosur në Kryeqytetin e tij, që e ndan një lumë, që s' ka kushte për lundrim.

Po ashtu para disa orësh prej burimit tepër sekret kuptuam, se Osama bin Ladeni i paska lindur një HALL tepër i madh me QEVERINË e shtetit. Ata që i garantonin jetën, tash i thonë:

-Pasuria e sjellur në këtë shtet Osama bin Ladenit i garanton jetë të qetë vetëm disa vjet dhe pasi të kuptojë bota se ai ndodhet në këtë shtet, shteti do të ketë pasoja të papara, qysh nesër QEVERIA do të bëjë kërkesë për dorëzimin e tij, për një SHUMË devizash, më të madhe se ajo që ka sjellë në shtetin ORTODOKS afër për njëmijë herë…???!!!

HAMDI BAJRAM

Këto ditë me anë të telefonit u bë një anketë për PARLAMENTARIN më të suksesshëm në Parlamentin Maqedon, prej pesë mijë të anketuarëve katërmijëetreqind-etrembëdhjetë thanë se parlamentari më i suksesshëm jo vetëm për këtë mandat, por qysh prej ardhjes së demokracisë është parlamentari HAMDI BAJRAM…???!!!

SEHIRXHIU

Në një çajtore të Shkupit dikush e pyet SARAÇIN:

-Eff. Saraç kohën e fundit jeni tepër pasiv, si për kombin ashtu edhe për fenë?! Saraçi përgjigjet:

-Unë jam si ai Hoxha, kur ata dy gratë shaheshin dhe u pajtuan se ajo që do të binte poshtë do të ishte e Hoxhës. Prandaj tash unë jam SEHIRXHI…???!!!

ALERGJIA

Një damë diku tha:

-Mua s' më pengojnë Shqiptarët e as gjuha e tyre, por kur e dëgjoj atë gjuhë, sikur pak më kap një ALERGJI. Nëse pas kësaj martese më jepet rasti të martohem për Shqiptar, ndoshta do të jetë më ndryshe…???!!!

CIVILIZIMI

Dikur baba i babës paska vrar një njeri, pse i paska marrë një vijë plugu të arës, kurse mua tash ma marrin tërë arën e unë duhej të hesht pasi jetoj në kohë të CIVILIZUAR. Vallë në cilën kohë jeton ky që ma merr arën?! A nuk shkruan në BIBLËN e tij: “SILLU ME TË SIÇ SILLET AI ME TY”…???!

ORTAKLLËKU

Xha Biti sa arriti në qytet, shpejt e shpejt i vizitoi të tërë zyrat për informim dhe për në ora katërmbëdhjetë caktoi konferencën.

Fiks në kohën e caktuar salla e Pallatit të Kulturës ishte plotë e përplotë me qytetarë dhe gazetarë, gazetash e radio-televizionesh. Xha Biti pa humbur kohë, pasi duhej tëkthehej në fshat e më vonë s’do të kishte autobus e ai duhej të paguante taxi, ia nisi me stilin e vet:

-Gazetarë të nderuar, ka një kohë të gjatë që unë s’mundem të rehatohem natën, prej shumë mendimesh të kësaj kohe të pa kohë. Për ate mos rehatim unë iu futa një studimi dhe besoj se ia kam arritur edhe zbulimit.

Gjersa atë kohë ishin në POZITË? Folnin aq ngadalë dhe me aq mundim sa unë, por edhe Ju mendoj se pritnit kur do të thirrej ai
SALLI I DOKTORATURËS, prej atyre pleqëve me në krye PLAKUN E URTË, që dikur ia dhanë Dr.Rumdum Adhamudhit.

Kurse ata të majeve, flitnin siç u gjëmonin armët. Por tani kur i ndërruan vendet i pari flet si i dyti, i dyti flet si i pari. ORTAKLLËKU me shkavin burra ne atje në fshat i themi se është i ZAFMETÇËM...

VETËVRASJA

Ca gazetarë të huaj i bënë një vizitë vendit tonë për të bërë ca intervista, e në mesin e tyre edhe me njërin nga njerëzit e parë të ALBANEVE nën KAURRI-siç u shprehën ata. Kishin kërkuar ca herë në të tre numrat e zotëriut, por të tre kishin treguar, se janë të shkyçur. Pastaj kishin marrur një taxi dhe

kishin shkuar drejtë e në banesën e tij. Derën ua kishte çelur një njeri i cili kur kupton ardhjen e tyre u thotë, se ajo banesë më nuk është në pronësinë të ati personi.

Rastësisht duke pirë në Restorant "RRAPI" një person kupton për ardhjen e tyre, u afrohet dhe ua jep një adresë për personin, që ata e kërkonin. Pa humbur kohë, ata u nisën në drejtim të asaj adrese. Sa iu afruan atij numri, panë një shtëpi shumë LUKSOZE, kurse përpara asaj një turmë të madhe njerëzish. E ndalën taxin dhe njëri pasi e hapi dritaren i pyeti për atë person. Ata pasi u shikuan në mes veti njëri u tha:

-Edhe ne presim që të takohemi me të afërmit e tij, pasi ai sot herët në mëngjes paska bërë VETËVRASJE…???!!!

PARADOKSI

Një ekspert për KRIME NDAJ NJERËZIMIT i punësuar pranë Tribunalit të Hagës në një tubim "SHKENCORO-POLITIK" tha:

Mbi tokë njerëzit hanë mishin e kafshëve, kurse në nënqiellin Maqedon nën tokë eshtrat e kafshëve i hanë eshtrat e njerëzve të "masakruar", por prej dy këmbëve lejnë një çerek ashti, prej brinjëve lejnë një ose dy, s' ka asnjë kokë, shenjat e tyre i shohin vetëm gazetarët maqedon dhe…???!!!

BARABARËSIA

Deri dje Universiteti i Tetovës kërkonte të jetë i BARABARTË me dy universitetet e Maqedonisë edhe ate me atë të Shkupit dhe atë të Manastirit, kurse sot këta dy të parit kërkojnë të jenë të Barabartë me njërin apo me të dy Universitetet e Tetovës…???!!!

TERRORISTËT

Zotëri Florens Hartman portparol i Tribunalit të Hagës me të kthyer në Hag përpara gazetarëve të huaj dhe të vendit tha:

-Me fjalë Maqedonët na bindën se Shqiptarët në Maqedoni janë KRIMINELË dhe TERRORISTA, por pasi dolëm në teren dhe i pamë veprat e Maqedonëve që kishin bërë kundër Shqiptarëve, atëherë u bindëm se KRIMINELE dhe TERRORISTA në Maqedoni janë MAQEDONET…???!!!

ÇO-VIÇI I ÇMENDUR

Gjatë votimit z. Rrugova tha se Kosova s' shpejti do të PAVARSOHET. Me të dëgjuar këtë lajm një farë KAURRI Ço-viç i nervozuar si Derri Millosh, gazetarëve u tha se ajo është një BUDALLAKI e Rrugovës?!

Me të dëgjuar këta fjalë z. Rrugova më s' nguroi si dikur, por ia ktheu duke u thënë gazetarëve:

-Ato janë fjalë ÇMENDURIE TË TË ÇMENDURIT ÇO-VIÇ, por edhe të tërë SEREBIKEVE…???!!!

DINAKËRIA ORTODOKSE

Ditët e fundit të gushtit, së bashku me Xha Bitin i kaluam në plazhin e bukur të Durrësit, kurse mbrëmjet nëpër lokalet me muzikë joshëse.

Xha Biti shpejt krijoi rrethin e vet me ca pleq të Shqipërisë dhe të Kosovës. Me ta shpesh hyrte në biseda për politikën shqiptare dhe ate botërore, dorën në zemër ata e dëgjonin më shumë vëmendje, na bëhej zemra mal.

Një ditë në TVSH dëgjuam reklamën "STUHIA SHQIPTARE, KUNDËR DINAKËRISË HELENE". Kjo reklamë xha Bitit ia kishte shtuar edhe më tepër oreksin për biseda të tilla.

Mbrëmjen e të nesërmes xha Biti doli pak më herët se ditëve të tjera, dhe kishte shkuar drejt e në lokalin në afërsi të rrotës së kuqe,ku edhe mblidheshin moshatarët etij. Në momentin kur ne arritëm ai u thonte shokëve e më tepër atyre të shqipërizëz, siç i thotë baca Salë-Kërçova:

-Më vjen mirë që dje me veshët e mi dëgjova prej TVSH, por me siguri me leje të Qeverisë Shqiptare reklamën "STUHIA SHQIPTARE, DINAKËRISË

HELENE”, kjo do të thotë se vetë më jeni bindur se keni punë me dredhitë ORTODOKSE, por akoma ata qeveritarët tuaj s’janë bindur se në Maqedoni kemi dinakërinë helene, serbe apo siç u thotë një autor “serebikve”, por bile edhe ate ruse.

Pas xha Bitit e mori fjalën një plak që i thonin xha Jorgo:

-Unë vet jam ortodoks, dhe më jam bindur se diçka nuk është në rregull, shembull konkret do të përmend kryqin në afërsi të Elbasanit.

Ajo dinakëri erdhi prej ortodoksve-SLLAV, që dikush ndoshta pati ndonjë dobi të vogël materijale. Me ndihmën e Zotit u bindën vëllezërit tanë dhe e tejkaluan mosmarrëveshjen. Unë do të isha lutur që edhe ju muslimanët dhe katolikët të vetëdijësoheni, për dinakëritë e huaja që na vinë me kulturën dhe fenë të mos ndikojë në kombin tonë të përbashkët, se ashtu do të jemi më të fortë, siç kemi qenë kundër dinakërisë, apo dinakërive.

Bisedës së xha Jorgos i duartrokitën dhe i ngritën dollinë...

QELBËRSIRA

Në parkun e qytetit pushonin dhe kuvendonin ca epror dhe luftëtarë të ish APJ-ës. Ca me shumë kënaqësi folilnin për ditët e lumtura, në atë shtet të fort, por në mesin e tyre kishte edhe kundërshtarë bile mjaftë të revolltuar. Njëri nga ata tha:

-Çfarë fortësie pati ish Jugosllavia, me një PORDHË Kosove u zhduk, e neve na la si delet pa bari?!- e dikush tjetër tha:

-Jugoslavia u zhduk, por QELBËSIRA mbeti.- ai të cilin e shohim shpeshherë edhe në ekran tha:

-Harrojeni QELBËRSIRËN Jugosllave, por çfarë do të bëjmë me QELBËSIRËN…???!!!

PROPOZIMI I RAMÇES

Para ca ditësh Parlamentit të Maqedonisë i arriti një LETËR PROTESTE nga RAMÇJA I SHUTKËS në të cilin thuhet:

-"MUA RAMÇES më vjen shumë kënaqësi, që sipas KËRKESËS dhe PROPOZIMIT tim në një SEANCË në SHUTKE, PARLAMENTI I MAQEDONISË vendosi të bëjë ndryshime në KUSHTETUTË, por unë RAMÇJA I SHUTKËS ndihem i ofenduar, që dikush më quan: RAMKO e dikush RAMKOV e dikush tjetër ia fut si ti vi për goje, unë Ju lutem që të korrigjoheni, pasi unë jam vetëm RAMÇE…

TRIM SHQIPTARI

Në kafenë e Hotel “UNION” të Kërçovës ishin ulur ca ish funksionarë të Maqedonisë, në mesin e tyre ishte edhe një SHQIPTAR. Prej konzumimit të tepërt të alkoolit të tërë ishin bërë trima. Dorën në zemër edhe ky SHQIPTARI dukej TRIM bile mbi TRIMA!

Duke dëgjuar lajmet më si ish funksionarë dhe të pirë, në EKRAN doli një PAROLLE, ku shkruante KJO ËSHTË MAQEDONI dhe në fund në vend të shenjës së piksimit kishin vizatuar KRYQIN! Atëherë reagoi TRIMI dihet kush SHQIPTARI:

-More të URUAR çfarë u duhej KRYQI?!- e dikush i tha:

-Ti e din fort mirë se Maqedonia është ORTODOKSE dhe SLLAVE atëherë TRIM SHQIPTARI u tha:

-Zotërinj KRYQET VENDOHEN NËPËR VARRE JU NËSE KENI VDEKUR NE SHQIPTARËT JEMI TË GJALLË…???!!!

ZHGËRRYEMJA

Gjer dje Maqedonia ishte ZHGËRRYER si BUALL E BUALLICË, por sot AJO është

ZHGËRRYER dhe KUNDERMON QELBËSIRË DERRI E DOSE…???!

EKSPERTI

Një EKSPERT botëror, pasi qëndroi ca ditë në Maqedoni në një PRES KONFERENCË tha:

-Unë dhe bota jemi bindur se Maqedonisë i duhej një POLICI E FORTË edhe ate BOTËRORE për të shuar EPSHET E SLLAVOMAQEDONËVE…?!

KËNAQËSIA

Autori pasi e përfundon një VEPËR në trup ndien një ngarkesë, por kur e shikon në dorë të lexuesit, atëherë ndien një KËNAQËSI si NËNËS kur ia afrojnë fëmijën në gji…

NDERSHMËRIA

I ndershmi në mesin e të pa ndershmëve e ka vështirë të ngeli i ndershëm gjer në fund…???!!!

GJUHA

Territorin e kemi dhe e shkelim e çfrytëzojmë, edhe GJUHËN e kemi por s' mundemi ta përdorim prandaj lindi lufta…?!

MUNDJA

Ate që s' mundemi ta mundim me vepra, mundohemi ta mundim me ofendime, akuza, etiketime e më në fund edhe me forcë…???!!!

GJYKIMI

Një gazetar e pyeti portparolin e qeverisë:

-Zotëri Portparol si i gjykoni ata që bënë teror në Parlament dhe nëpër Ambasadat e shteteve perëndimore?- ai përgjigjet:

-Dihet, ne dhe bota i kemi shpallur si Terrorist Shqiptarët!- por gazetari ia tërheq vërejtjen se ata nuk janë shqiptarë. Ai përgjigjet:

-Zotëri gazetarë, në këtë shtet janë shpallur më terroristët…???!!!

SHUPLAKA

Një person pasi e bëri parkingun e veturës në vendin e ndaluar, polici ndodhej aty ia tërhoqi vërejtjen, por ai tha:

-A nuk më njihni mua?!- polici i tha:

-Jo unë nuk u njohë dhe vetura nuk e ka aty vendin.- ai i

thotë:

-Ta dishë se unë jam Hamdi Bajram deputet parlamentar-XHYPI.

Mbrojtës i Shtetit Maqedon prej atyre që e shkelin. Veçanërisht prej terroristëve shqiptarë.- Atëherë polici i afrohet dhe i thotë:

-Edhe unë jam njëri nga ata që e mbroj shtetin nga ata që e shkelin ligjin, prandaj ta tërhoqa vërejtjen dhe i mëshon shuplakë…?!

FENOMENI

Karl Bildin e pyet një gazetar?

-Z. Bild, pasi largoheni prej këtij nënqielli Ballkanik, a mundeni të na tregoni ndonjë FENOMEN të këtij nënqielli?!- atëherë z. Bild merr frymë thellë, pushon pak dhe ia fillon:

-Jam bindur në dy fenomene:

1. Të gjithë sllavët në shpirt kanë ngulitur: rrenat, akuzat, ofendimet, etiketimet, pra me një fjalë aspak s' kanë burrëri dhe

2. Të gjithë shqiptarët në shpirt kanë fjalën burrërore apo siç i thonë ata BESËN dhe luftën e pastër TRIMËRORE…?!

NUSET DHE VJEHËRRAT
AMORTIZIMI

Një nuse në punë u thotë shoqeve:

-Nëse doni t' ua shes apo t' ua jap vjehrrën. Vërtetë trupin e ka të amortizuar, ama kokën e ka në rregull. Për një ditë e një natë shtëpinë do t' ua bëjë lesh e li…!

IKJA

Nusja pasi kthehet prej pune, pa e përshëndetur vjehrrën e merr fëmijën dhe fillon ta ledhatojë. Vjehërra e mbushur gjer në fyt, fillon të bërtasi. Nusja njëherë hesht, por më në fund edhe ajo i thotë ca fjalë ama pak si ofenduse. Atëherë vjehërra çohet dhe del

për dere, që kurrë më s’ do të kthehet në atë derë. Pas pak vjen djali burri i nuses, nusja sa e përshëndet pak si tepër e revolltuar i thotë:

-Iku mami! Ai duke qeshur i

thotë:

-Për cilin iku, u martua?! nusja i thotë:

-Te vëllau yt, atje s’ paska punë, fëmijët i ka të rritur…!

FJALOSJA

Pas shumë fjalosjesh të nuses me vjehrrin, nusja i thotë:

-Ditën e pazarit të dyja lopët të mi shporrish prej grazhdit! Vjehërri si ktheu fjalë, por ditën e pazarit i merr lopët dhe i nxjerrë në pazar. Nusja tërë ditën e gëzuar, dhe herë fjaloset me vjehrrën. Vjehërri le që nuk i shet lopët, por i blen edhe dy të tjera. Dorën në zemër, ajo qe e tepërt, por ndryshe nuk dinte si ta plasi nusen…?!

PENSIONI

Vjehërra përherë pensionin ia jepte nuses, por një ditë fjalosen aq shumë, sa që tërë muajin vjehërra e kaloi në vetmi, në një dhomë pa asnjë farë kujdesi. Si mori pensionin nusja u paraqit në derë duke i thënë:

-Unë erdha, do të ma japish pensionin?! Vjehërra i thotë:

-Ik ne s' bisedojmë! nusja i thotë:

-Ne prap s' do të bisedojmë, ti vetëm ma jep pensionin…!

TAPIA

Nëna pasi ia shkruan tërë pasurinë djalit në gjyq dhe ai e merr tapinë, shpejt fillojnë grindjet në mes të nuses dhe vjehrrës. Vjehërra me shumë kujdes dhe njerzëllëk i thotë nuses:

-Dikur ta dhash djalin, tash ua dhash edhe pasurinë, që plotë pesdhjetë vjetë e kemi fituar me atë rahmetlinë, e ti një ditë s' më le të rehatohem! nusja i thotë:

-Jo që s' do të le të rehatohesh, por pas marrjes së pasurisë dhe pasi e futa në gji tapinë, tash moj shtrigë shumë shpejt do ta marrë edhe shpirtin…???!!!

TRISHTIMI

Të martën në ora trembëdhjetë pa tre minuta Kërçovarët dëgjuan tri herë nga tri të rame ÇANGU, pastaj ca zëra si ANGULLIMA qensh, që trishtuan popullatën për ndonjë vdekje masive. Pasi u qetësua

ajo angullimë dikush prej lart në Kala me megafon tha se paskan COFUR ca QEFINARE dhe PETICIONISTA…???!!!

KËNAQËSIA

Duke dalë prej sallës së Parlamentit Maqedon, një gazetarë e pyet parlamentarin Stojkovski për atë kënaqësi, që i dukej në fytyrë ai përgjigjet:

-Pas shumë replikave që pata me parlamentarët Maqedonët Shqiptarë i

binda se ata janë pjesë e Popullit Maqedon, që shpejt kanë pranuar Islamin dhe rastësisht flasin gjuhën e një shteti fqinjë! gazetari i habitur prap e pyet:

-Si u bindët Ju se ata janë bindur në këtë që thatë?!- ai përgjigjet:

-Pasi unë i thash këto fjalë ata më se hapën gojën…???!!!

DARKA SOLEMNE

Në qytetin e bukur SEVILJA, në një hotel me pesë yje, Zoti Sollana organizoi një DARKË SOLEMNE me shumë të ftuar nga tërë bota. Për zbavitje kishte thirrur Yjet më të njohur botëror. Pasi u qetësua muzika njëri nga të pranishmit e pyeti:

-Zoti Sollana, duket se jeni shumë të lodhur. Ne tash kemi dëgjuar për atë shtetin e vogël ORTODOKS, apo siç i thonë BAJRAM REPUBLIKË, Ju lutemi na tregoni si shkojnë punët në atë republikë? Solana thotë:

-Mua punët më kanë shkuar mirë, sa u përket atyre kanë shumë ngatërresa. Atëherë ai zotëria që bëri pyetjen, u çua në këmbë me viskin në dorë duke thënë:

-Gëzuar, z. Sollana dhe Ju të tjerë, prej sot LORKA do të pushojë i qetë…???!!!

TERRORIZMI

Një parlamentar Evropian në Samitin kundër terrorizmit, që u mbajtë këto ditë në Strazburg, pasi doli në foltore me një revoltë të pa parë tha:

-Ata që folin edhe në ëndërr kundër terrorizmit, më është vërtetuar se shteti i tyre me Qeveri, Polici dhe Ushtri ushtrojnë një TERRORIZIM të pa parë kundër popullatës së vet…???!!!

KOLLTUKU

Në afërsi të restoranit “ELITA” rastësisht takova xha Bitin duke biseduar me një moshatar të vetin. Pasi u përshëndetëm i thirra të pinim diçka në tavarenën e restorantit “ELITA”, që ata me kënaqësi pranuan. Duke biseduar erdhëm te fjala KOLLTUK, atëherë xha Biti pasi qeshi ia nisi:

-Unë atë pakë shkollë e kam bërë në kohën e Sërbisë, mësues kam pasur Miliqin, që na vritëte me dru sobe. Mirë më kujtohet kur i tha babës se sërbët kolltukun e ëndërrojnë të butë gjersa nuk ulen, pasi ulen ai u bëhet plotë ferra. Te ju shqiptarët është ndryshe, Ju pasi uleni ia ndieni butësinë dhe lezetin, duke ndejtur gjer atëherë kur krejtësisht e humbin takatin dhe dorzoheni me pasoja të pa para…???!!!

MISHIN TA HANË POR KOCKAT TI RUAJNË

Gotave u dukej fundi, por edhe mezja edhe pse e vobekët edhe ajo ishte nga fundi, ashtu si bisedave dhe rrezeve të diellit në këtë fillim vjeshte. Dikush diçka bluante në tru, e dikush shikonte atë macen që luante nëpër SHATERVANIN e shterur, ashtu si ai BOEMI i dikurshëm, që tash i kanë ngelur në tru tamam si Rrapit: galat, zogjtë, miza dhe BULLARI e dikush poshtë si macja e vetëshpallur BOEME.

Pagesa ishte bërë, por edhe xhepat apo kuletat kishin ngelur pa asnjë metalik. Rastësisht njëri i pa tre PARLAMENTARË, që zbritnin rrugës me kalldrëm qysh në kohën e Turkut. Dorën në zemër ne s' pritnim të na përshëndesin e jo të uleshin me ne, por ja ndodhi kjo e dyta, bile pa mos na pyetur. Ne u shikuam në mes veti dhe thamë: që të ikim. Në atë çast PARLAMENTARËT mbi tavolinë lëshuan çantat e dorës, që rrapëlluan shumë ashtu siç ishin edhe të fryera. Atëherë njëri tha:

-Ku do të shkoni?- duke i parë gotat e zbrazura dhe një grumbull qepësh dhe një spec djegës në skajin e pjatës. Thirri kamarierin, porositi nga një VISKI dopjo siç i thonë në Shqipëri. Të piqni prej mishit më të mirë, dhe sa më shpejt të hiqet pjata me qepë, se e kishin qelbur tërë Rrapi për rreth. E njëri tha me shumë IRONI, ky Rrapi më nuk është i atij BOEMIT, por është i yni.

Atëherë edhe MACJA kishte hipur në vendin më të lart të SHATERVANIT dhe me shumë kënaqësi shikonte PARLAMENTARIN, që dikur kishte thënë: "POETET E VETËSHPALLUR", e dikush i paska thënë, se ata janë të VETËKRIJUAR. Kurse neve dorën në zemër na digjnin zorrët prej rakisë –BULLUT-, qepës dhe specave djegës.

Pasi cakërruam gotat, arriti edhe mishi i pjekur me erën e lezetshme ku edhe macja filloi të lëpihet, por edhe sallatat e llojëllojshme, më si për

PARLAMENTARË. Ashtu filloi të zhvillohet edhe biseda. Tash e kuptuam atë shprehjen e POPULLIT "I JOTI MISHIN TA HANË POR KOCKAT TI RUAN". Ashtu njëri na pyeti për hallet dhe punët e SHSHSHM-ës, por edhe për punimet personale dhe për veprat e gatshme. Njëri mirë e mbante në mend bisedën, që dikur kishim biseduar SHSHSHM-ja u ka botuar të tërëve nga një vepër atyre që janë në KRYESI, përveç njërit që është bashkëvendas i KRYETARIT, që mos keq kuptojnë të tjerët, por me kusht që herën tjetër të përfshihet edhe ai. Por herën tjetër ndodhi ajo e para, duke i

Thënë se ai duhej të pritëte ndonjë kohë më të mirë. Pra do të thotë se KRYETARI botoi dy vepra që është më e keqja pa botuar ngelën VËLLIMET e BACËS SALË, pasi edhe ai është anëtarë KRYESIE.

Duke prekur çantën e dorës një Parlamentar tha, se ajo nuk është problem i madh, pasi ata mjete munden të sigurohen prej tyre, pasi disa prej tyre për një të ngritur të gishtave, sigurojnë disa qindra mijëra DOJÇ-MARKA. Biseda vazhdonte qetë e ngadalë, si pihej VISKI, hahej mishi tamam si në përrallë.

Këto çaste të bukura përrallore na i prishi kamarieri i
cili erdhi të bënte pagesën, pasi i kalonte orari i punës, kurse Parlamentarët vazhdonin bisedën si në Parlament. Ne ikëm se na pritnin punët, që si kishim kryer gjatë ditës.

Biseda e Parlamentarëve ndoshta akoma vazhdon, për rendin e ditës, që atë seancë kanë: Pagesën e ushqimit, pijeve dhe FINANSIMIN e VEPRAVE të lartpërmendura, por me kusht të markave të marra vetëm prej ngritjes së gishtave, për të mirën e SLLAVOMAQDONËVE…???!!!

KOM-ROM-MAK

Si bota ashtu edhe ne e përshëndesim formimin e Kombit më të Ri në botë, që pas shumë debatesh më në fund arritën edhe ta pagëzonin me emrin shumë simpatik: KOM-ROM-MAK. Pa humbur kohë formuan edhe Trupin Kordinues, kurse ai për pak kohë shpalli konkursin për kryetar të këtij Kombi. Pasi akoma s' kanë shkolla të mesme e ku më universitet, kushti për kryetar është shumë i lehtë dhe i thjeshtë. Personi i këtij Kombi që i ka ata që dhelpra ecte pas dashit më të mëdhaja, pas asnjëfarë kushti tjetër do të ulej në fotelen e butë. Dikush që mendonte se është më intelegjent dhe duhej të bëhet ai kryetarë, kërkoi që të bëhej një testim për trurin. Dorën në zemër ai kishte të drejtë, por kësaj kërkese askush s' ia vuri veshin.

Grupi Kordinues caktoi disa grupe me peshore në dorë, që të bënte peshimin nëpër rrugët e qytetit, atyre

që mendonin se i plotsojnë kushtet. Rastësisht një grup hyri në restorant, ku kishte shumë klientë të moshave të ndryshme. Përpara u doli përgjegjësi i sallës, duke menduar se ato do të kërkonin apo dë pinin diçka. Pasi ia sqaruan përgjegjësi u tha: “Për mençuri pyeteni atë burrin i cili është ulur në tavolinën e shtatë dhe për tërë ditën pin vetëm një kafe, kurse për këtë që dëgjova shkoni në tavolinën e nëntë. Te ai do të gjeni material, për të pranishmit për Ju dhe për Trupin Kordinues”. Ata shkuan iu prezentuan, që më ai de fakto prej aty u bë KRYETAR, sa ua hapi këmbët pa humbur kohë ata thirrën një veturë speciale, sepse frigoheshin mos i binë, le që do të ngelnin pa Kryetarë, por do të humbnin SHPËRBLIMIN e konkursit. Sa arritën te trupi Kordinues me shumë CEREMONI i bënë peshimin e HERDHEVE për shumicën të pa parë gjer në atë moment. Shpejt e shpejt thirrën edhe ca njerëz të rangut të tij, për nga posti, dikush tha se duhej të thirrnin edhe njerëz të huaj, por ata më kishin kuptuar dhe shumica ishin në rrugë, por ca ishin në dilemë, se ç’ do të ishte MYSLIMAN apo ORTODOKS. Dorën në zemër të dy palët dëshironin të jetë i përkatësisë së tyre.

Edhe pse peshimi ishte bërë gati për para një ore akoma në EKRAN qëndrontë numri katërmbëdhjetë kilogram e dyqind gram. Kryetarin e kishim venduar në një PIEDESTAL, ku të gjithë kalonin si në një

Kortezh të përmortshëm. Ai i përshëndetëte duke ua treguar numrin në ekran. Shumë burra shtetesh dhe gazetarësh dëshironin të dinin për ushqimin apo ushtrimet e bëra që ka ardhur deri te ajo peshë. Kryetari kërkoi një orë pushim dhe t' ia thirrin atë personin që përherë ulej në tavolinën me numrin shtatë. Si bëri konsultimin me atë person, e hapën derën por në dhomë ngeli vetëm zëdhënësi i kryetarit. Në pyetjen e gazetarëve për sekrete ai u përgjegj shumë shkurt:

-Kryetari sekretet nuk i tregon gjersa të jetë i gjallë, por ata do ti shkruaj në mamoaret e tij.. atëherë dikush tha:

-Le që është i mençur, por ai do të na kthej në MONIZËM…???!

PETICIONI

Pas peticionit të disa HOXHËHALLVARËVE kërçovarë, kundër poetit dhe gazetarit të tyre z. B.Rr si njeri jo devotshëm ndaj Zotit, pasi në kokë mban kaçket, nuk shkon në xhami, por viziton kafenetë.

Prej këtij gjesti të hoxhallvarëve ai nuk u mërzit fare. Vazhdoi punën si më parë. Pas një kohe dëgjon një zë:

-Të lumt për poezinë “DURIMI” dhe punën që vazhdove. Fjala e ime që dërgova pas të dërguarit t’ im ishte fjala “IKRE” e jo: lutmu, falmu… prej atëherë bile edhe tash hoxhëhallvarët punojnë sipas interesit të tyre. Ç’ është më e keqja ata nuk shohin çka bën bota dhe sa i shtyp KRISHTENIZMI.

Ti mos u brengos e ke fituar një vend në mes të luleve, por të mos bësh gabime, edhe pse: s’ lutesh, falesh... por të vazhdosh si gjer tani me punën tënde krijuese...

ANTOLOGJIA FEMËR

Këto ditë Kërçova është rehatuar prej politikës së ditës, jo se janë rregulluar punët, por prej një farë HABERI-FAT!

Unë si e mblodha bërllokun në dy qeska najlloni, u drejtova drejt kontejnerit që e kam në largësi afër njëqind hapa njeriu. Sa dola në rrugë te kontejnerët pashë një plakë, që përziente në njërin nga kontejnerët. Sa u afrova dëgjova se plaka edhe këndonte edhe recitonte. Unë i hodha qeskat dhe u ndala aty afër, që të kuptojë pse plaka ishte aq e disponuar! Plaka më vërejti e hudhi një pako që kishte në dorë dhe më tha:

-Unë kam kënduar nëpër dasma, i kam rënë daires, bile më mirë se Naxhije xhypka. Unë i dijë edhe disa vjersha që i dinë mbesa ime. Këtu kërkoj një shami dhe një palë këpucë. Sa më shpejt duhej të shkojë në Tetovë te Foto "VENUSI", pasi ai paska aparaturë më të mirë, për të bërë një FOTO për atë –ANTOLOGJINË FEMËR-. Tash e kam shansin të bëhem e pasur, por edhe me NAM. Siç më thanë unë do të bëhem SHTATE. Kupton ti apo s' kupton! Do të përkthehet në shtatë gjuhë të botës. Për punimet e përkëthyera do të më japin shtatë mijë marka gjermane. Antologjinë femër do ta çojnë edhe në Gjermani. Atje unë kam djalin, nusen, nipër dhe mbesa. Siç më thanë do ta dërgojnë edhe në Amerikë, atje kam vajzën me dhëndër dhe plotë njerëz e dashamirë.

Plaka do të tregonte shumë fjalë të tjera, por ca qenë dhe buça që ishin aty afër filluan të lehin, pasi edhe ata pritnin racionin e ditës prej kontejnerit të plakës. Unë vazhdova rrugën që sa më parë të blejë gazetat e ditës, ndoshta prej tyre do të mësoja më tepër për ate që më flitëte plaka. Për të arritur gjer te kiosku i gazetave duhej të kaloja rrugën rrëzë Kalës. Duke kaluar atë rrugë, pashë një plak duke zbritur shkallëve të Kalës. U ndal në njërën prej tyre dhe ia tha:

O Ju malet me dëborë
lumë unë ç' kam në dorë…!

Unë u ndala, prita të mbaronte poezinë dhe pastaj e përshëndeta duke i thënë se shumë herët paska dalë në natyrë, e ai më tha:

-Kam dalë për frymëzim, të shkruaj një poezi për ANATOMI-FEMËR! Unë e korrigjova, për Antologji femër. Po de po tha për ate. E unë i thash Ju zotëri jeni mashkull! Por ai duke qeshur tha:

-Kush të pyet sot çka je mashkull apo femër, kryesorja është të bëhesh i pasur mbrenda një nate!

Unë vazhdova rrugën me gazetën në dorë, duke u menduar se si ata marka të mallkuara njerëzve ua kanë humbur krejt ate që është njerëzore. Nga kjo gjendje më nxorrën një grup nxënësish, që dolën prej një rruge qorre. Në mesin e tyre kishte edhe ca prej Kombit të posa formuar KOM-ROM-MAK, pasi prej këtij viti ata paskan filluar të mësojnë në gjuhën shqipe. Jo se e duan Shqipen, por pse prindërit e tyre ka një kohë te Shqiptarët me tupanat e tyre s' kanë bërë as RRUM e as DUM.

Ajo që ishte pak më e rritura u tha shoqeve:

-Unë do hy në Romani, me siguri mendoni për në Antologji, pasi kam mësuar disa poezi. Atë moment nxënësit hyrën në oborr të shkollës, unë duke kaluar rrugën përpak i ika aksidentit të një veture përplotë gra që shpejtonin pas THESARIT…???!!!

DASHURIÇKAT

Akoma pa aterruar avioni, z. Robertson hetoi se diçka nuk është në rregull, në tokën shqiptare. Prandaj ai i tha pilotit:

-Unë do të zbres, por ti mos i shuaj motorrët!

Pasi zbriti z. Robertson, atë me një buzëqeshje e përshëndeti ministresha e bukur shqiptare, por ajo nuk mjaftonte, që ta bindi z. Robertson për sigurinë e tij. Sa i lëshuan duart ai shpejt u kthye në avionin e vet dhe kapi mobilin. Me urdhër të prerë urdhëroi, që në kohë sa më të shpejtë në Aeroportin e Rinasit të aterrojnë dy helikopterë, me forca të NATO-s, për sigurinë e tij, duke u thënë:

-Këtë e bëj, pasi kjo ministresha e bukur më duket se paska dalë të bëjë pritjen e atij Romeos-shqiptaro-

grek, që kthehet nga DASHURIÇKAT e bëra nëpër Greqi e jo njeriun e parë të botës…???!!!

RREZIKSHMËRIA

Rrezikshmëria e një kombi janë ata njerëz, që mbahen të Mëdhenj me me vepra të Vogla, apo edhe ata si kanë…???!

BISEDA ME ZOTIN

Para ca vitesh në pallatin e vet, i cili ndodhet në mes të Tiranës Bablok Anastasi një natë vonë kishte biseduar me Zotin! Në atë bisedë të gjatë, ku Bablok Anastasi ia kishte treguar hallet e tij me Shqiptarët. Në fund Zoti i paska thënë:

-Bërua me dije Shqiptarëve, se mëkati më i madh për ta do të jetë po të vijë në Postin e Juaj një Shqiptar?!

Pak para ca ditësh me Zotin paska biseduar edhe Babloku Millosheviç, edhe ate në një birucë në Hag. Edhe atij i paska thënë Zoti se lufta e tij paska qenë e drejtë dhe e shenjtë, dhe se Kosova na qenka Serbe?!

Këto ditë paskan biseduar me Zotin një shqiptarë i ndershëm dhe një maqedon patriot, edhe atyre u paska thënë Zoti:

-Shqiptarët po të gërvishin më thellë do të binden se dikur na paskan qenë maqedon-pirrolla…???!!!

DUELI

Pas duelit me z. Demaçin, zonjë Radë e pritnin gazetarë të cilët i bënë shumë pyetje, ndër ta edhe kjo:

-Z. Radë çdo të na thoni, për serbishten e z. Demaçit dhe Kryqin e Juaj mbi tesha? Ajo shkurt përgjigjet:

-Vetëm një vullosje e Serbisë në këtë vend, pastaj dikush e pyeti:

-Z. Radë ç' mendim tash keni për z. Demaçin dhe popullin e tij? Ajo do të thotë:

-Unë shumë pak, apo fare se kam njohur Demaçin përpara. Edhe në këtë duel ai nuk tregoi ndonjë pjekuri, siç e ceku ai disa herë Intelektual. Sa i përket popullit të tij unë s' mendoj aspak ndryshe, apo më mirë të them as më mirëe as më keq se çka u ka menduar Shoku Tito, e kurrë s' do hek dorë prej mendimit të Zotit Millosheviç…???!!!

COFDEKJA E NJERIUT TË MADH

Dielli lindi pa asnjë re në qiell. Në tërë minaret thirrej sall po ashtu në tërë kishat binin këmbanat, në qytetin e Salës së pa ndarë. Në fund të sallit në gjuhën zyrtare, pra të shtetit tregonin se natën që shkoi cofvdiq-vdiqcofi njeriu më i madh i kësaj ane.

Aeroplanët filluan të buçasin në të katër anët, nga referatet e biografive të përgatitura qysh më parë. Ishin aq të dhimbshëm sa filluan të ulurojnë edhe macat edhe qentë, e për çudi pallnin edhe gomarët. E nga varri filloi të dali një flakë e çuditshme duke u lutur që atë njeri-… mos ta fusin në varr veç me savan! Me shkronja të mëdhaja u shkrua në mesin e flakës: bëni një ARKËVARR, që kurrë të mos ketë kontakt me tokën mëmë!

Pak para se ti afroheshin varrit përpara na dolën ca burra të armatosur. Kortezhi u ndal, ata u afruan te arkëvarri dhe vizatuan një kryq, hoxha pa hanendje vizatoi hënën. Ata bënë disa kryqa dhe na i drejtuan armët, ne sa deshëm të vazhdonim për te varrezat njëri prej tyre tha se na si kishim vënduar titullin. Shpejt prej xhepi nxorri një shkums të kuq dhe filloi të shkarravisi: Dr.Mr.Prof…Hoxha i hidhëruar doli në anën tjetër ia rrëmbeu shkumsin dhe filloi të shkruaj:

Haxhi, Efendi, kadi, mifti, hafij… dhe në arkëvarr vizatoi disa hëna!

U habitëm nga freskia e menjëhershme e asaj dite me temperaturë tropike. Mbi ne pamë një tufë korbash, që me shpejtësi na e rrëmbyen arkëvarrin e çuan lart në hava duke luajtur si me top, gjersa prej arkëvarrit s' mbeti gjë, atëherë edhe varri u qetsua…

TERRORISTËT

Një gazetar i huaj e pyet një ministër maqedon:

-Z. Ministër, Ju lutem të më tregoni pse Ju dhe tërë mediat maqedone Shqiptarët i thirrni TERRORISTA?! Pasi Ju në Parlamentin e Juaj vendosët, por edhe BOTA tha se ata janë EKSTERMISTA.- ai pasi u mendua pak, mblodhi krahët dhe përgjigjet:

-Ai që në shpirt ka një MILLEF, PESHË apo diçka, s' di ç' të them ka të DREJTË… të thotë çka të dojë…???!!!

TANKA-MANKA-ÇANKA

Sot nëpërmes valëve të një Radio Stacioni, ku shumë përziheshin valët, arrita të dëgjoj emrin TANKA-MANKA-ÇANKA dhe se ajo ishte një funksionare e lart. Ajo nëpërmes të këtyre valëve URONTE DITËN E PARË TË VITIT SHKOLLOR VETËM NJË SHKOLLE QË GJINDET NË NJË FSHAT TË SHTIPIT.

Ajo SHKOLLË qenka SHEMBULL për DREJTËSI, BARAZI dhe BASHKËJETESË, në atë anë, në Maqedoni bile edhe në BALLKAN. Ky vit shkollor fillon me tetë nxënës edhe ate me një maqedon, dy romë dhe pesë TURQE. Mësimi do të ZHVILLOHET në gjuhën MAQEDONE. Mësuesi na qenka MAQEDON, por SHERBËTORJA, thonë se është rome, por ajo mbahet si TURKESHE mjaftë LOJALE dhe e NDERSHME, që s' besohet të ketë tjetër në Maqedoninë…???!!!

TRADHËTIA KOMBËTARE

Një shok e pyeti Bitin:

-Bit, a me të vërtetë ai GJENERALI ka bërë aq krime që ta dërgojnë në HAG?!- Biti përgjigjet:

-Jo, ai s' ka bërë KRIME, e as ka urdhëruar, që dikush të bëjë KRIME, por GJENERALIN e ka MALLKUAR ZOTI për TRADHËTI KOMBËTARE…???!!!

TRASHËGIMIA

Një i deleguar perëndimor e pyet një parlamentar maqedon:

-Zotëri parlamentar, a nuk Ju duken si të tepërta: akuzat, ofendimet ndaj shqiptarëve dhe veçanërisht ajo e qame si fëmijët?!- ai i përgjigjet:

-Rrenat, ofendimet dhe akuzat i kemi trashëgim, kurse të qamen e bëjmë, pasi s' kemi AFTËSI FORCE. Ndoshta Juve do tu vijë keq dhe do të na përkrahni, së paku e bëjmë edhe për LEMOSHE…???!!!

DËNIM-TATIM

Në sallën e madhe të Hotel "UNION" u mbajtë një mbledhje e jashtëzakonshme me të gjitha strukturat politike, ekonomike, tregtare, BUDALLARE… të tëra ishin SLLAVOMAQEDONARE! Në rend dite ishte një pikë. Humjet hotelierike.

Pas shumë bisedash, unanimisht erdhën në përfundim se SHKAKTARI kryesor për humbjet e mëdhaja janë SHIPTARITË. Përfaqsuesi i Hotel "UNION" tha se këtë vit janë në humbje 60 mijë marka dojç. Pasi sipas vitit të kaluar në këtë hotel është dashur të kremtohen 30 DASMA, a kjo vlen edhe për hotele të tjera!

U vendos, që çdo shqiptar të paguaj pesë përqind, për çdo faturë në emër të HATELIERISË edhe ate si DËNIM, që vitin e ardhshëm, kjo të mos përsëritet, por të gjithë DASMAT shqiptare të bëhen në OBJEKTE SLLAVOMAQEDONO SHTETËRORE! Do të munden të lirohen në OBJEKTE të tjera me kusht që të paguajn nga dy mijë dojç marka për HOTELET SLLAVOMAQEDONE, këtë prej sot se luan as TOPI…AMEN…???!!!

ADOLESHENTËT

Një PARLAMENTAR i PARLAMENTIT të EVROPËS i cili disa herë paska vizituar Maqedoninë dhe disa herë paska folur në PARLAMENTIN e MAQEDONISË, përpara gazetarëve dual me një REVOLTË të pa parë. Nuk u përgjegj në asnjë pyetje, vetëm shkurt tha:

-PARLAMENTARËT SLLAVOMAQEDON në PARLAMENT vinë si njerëz të pjekur, por aty SHËNDRROHEN në ADOLESHENTË të KËQINJË…???!!!

MALLKIMI

Pas shumë përgjigjeve, z. FROVIK gazetarëve u tha:

-Nëse doni dikend të MALLKONI, thoni Zoti JU DHASHTE KOJSHI një MAQEDON, apo si FUNKSIONAR BOTËROR të udhëtoni tri herë në atë SHTET…???!!!

PRAPANICA

Në botë SLLAVOMAQEDONËT kanë shumë MIQ, por si të VIZITOJNË Maqedoninë BINDEN se këta njerëz nuk janë të SINQERTË dhe aspak SERIOZË në bisedime. Shpejt binden se SLLAVOMAQEDONËT PRAPANICËN e kanë në PERËNDIM, kurse TRURIN e SËMUAR në LINDJE…???!!!

SËMUNDJA UNIKATE

Në një bisedë me të huaj, MINISTRI I ARSIMIT tha:

-Ne PUNËN tonë e kryem me NDER dhe në KOHË, bëmë SHKATËRRIMIN E SHUMËSHKOLLAVE SHQIPE e tash Ju të huaj ose NDËRTONI (por me kusht edhe neve të na jepni aq para, sa do të nevojiten për ndërtimin e tyre), por më mirë do të jetë që SHQIPTARËT të mësojnë nëpër SHATORA…???!!!

ZBULIMI

Zbulimi më i MADH i MAQEDONOULLOGEVE, SHKENCTARËVE dhe POLITIKOLLOGËVE TË ASHTUQUAJTURIT KOMB SLLAVOMAQEDON, por nëse EGZISTON është vetëm SHPREHJA –TAKANAREÇENATA-TATATA- ose SHQIP sipas Dr. KASIQIT –ASHTUQUAJTURA-RARARA-…???!!!

HALLI

Pas një bisede me BOTËRORËT, Savo KLIMOSKI përpara gazetareve paraqitet me shumë nervozë. Një gazetar i thotë:

-Z. Klime, duket se keni ra në HALL me botërorët?- ai i thotë:

-S' binden as me rrena, as me akuza as bile me forcën tonë. Dikush i thotë, paskeni ra në HALL tamam si Shqiptarët me JU. Ai thotë:

-Çfarë HALLI kanë Shqiptarët me ne. Shqiptarët ka të kthehen ndodhen në mesin e shqiptarëve, ose më mirë të them në SHQIPËRI, por çdo të bëhet me NE…???!!!

TALIBANËT

Dikur Lupçe Georgieski tha:

-Të tërë Shqiptarët e Maqedonisë janë Talibanë! Por më vonë edhe deputeti Mersel Bilalli tha:

-Lupçe Georgieski dhe Stojan Andovi janë Talibanë- kuptohet me tërë njerëzit e tyre. Pra shumica e popullatës në Maqedoni na qenkan Talibanë Myslimanë dhe Talibanë Ortodoks, por këta të dytët janë shumë të rrezikshëm, pasi Maqedoninë e fjalosën me tërë botën…???!!!

LËVIZJA E DERËS

Pas Aktit Çnjerrëzor në Nju Jork dhe Uashington shumë funksionarë maqedonë e veçanërisht Kryetari Boris, vend e pa vend folë duke përkrahur SHBA-të,

në luftën kundër terrorizmit. Pastaj me një MJESHTRI krahason terrorizmin e atjeshëm, me TERRORIZMIN E ASHTUQUAJTUR-SHQIPTARË. Për këte POPULLI YNË thotë: “PO S’ PATE PUNË, LËVIZE DERËN”…???!!!

MADE IN POPOVA SHAPKA

Këto ditë në qytetin e Kërçovës u hap një Free shop, me robë të përzier, edhe ate prej njerëzve më të besuar të shtetit. Më së shumti ka:

Televizora, radio aparatë, frigoriferë, por mundeni të gjeni edhe lodra për fëmijë. Në shumë vende shkruan: “SË SHPEJTI DO TË KEMI EDHE MË SHUMË MALLËRA”. Të tërë mallërat janë të cilsisë së lartë dhe në të tërë do të shkruaj- MADE IN POPOVA SHAPKA…???!!!

LODHJA

Njerëzit i ka lodhur MENÇURIA prandaj kanë filluar të bëhen -BUDALLENJ-.

TË QESHURAT

Pas Pres Konferencës, një gazetare e pyet shoqen e vet, më të vjetër-gazetare:

-Ç' qe kjo e qeshur sot me Konferencierin?- ajo i përgjigjet:

-Si fëmijë e mbajë mend shumë mirë, kurse tash e përjetoj edhe vetë. Gjyshi dhe gjyshja kur fjaloseshin inat mbanin me java të tëra. Por pas atij inati, gjyshja çoheshte herët dhe na bënte: llokume, pite apo diçka tjetër, kurse gjyshi na blente karamele. Kur ktheheshin prindërit nga puna qeshnin duke thënë: "SONTE QENKAN PAJTUAR PLEQTE"…???!!!

NGATËRRIMI

Dikur me një gjuhë të pastër shqipe i thanë:

-Kush je ti të shkruash keq për shtetit?- kurse tash me një gjuhë të bastarduar-ARABO-TURKO-SLLAVOMAQEDONO-SHQIPTARE- i thanë:

-Ne adhuruesit e Dr. Rrumbumit do ta djegim edhe shtëpinë edhe krijimtarinë, sëbashku me atë plakun e mençur, që na lexon gazetat. Ai u tha:

-Më duket se jeni ngatërruar si ajo arusha që turrej pas lepurit nëpër shelgjishtëra. Pasi u lodh për vdekje, iu dorzua lepurit, atëherë lepuri ia bëri atë punë. Ju mundeni të ma digjni shtëpinë, por dhe krijimtarinë, por vetëm ate që është e pa botuar, kurse për atë që është e botuar mundeni të më kapni për herdhesh…???!!!

BILETAT SHITEN SI HALLVA

Para disa ditësh, në shumë shitore të shtetit e private ishin vënduar reklama me të cilat lajmërohej se më datë 14.11.90 në qytetin tonë- Kërçovë musafirë do të jenë: Leci, Çumili dhe Cima.

Edhe pse çmimi gjer tani më i lart, biletat u shitën si hallva. E në këtë kohë të krizës ekonomike tre, katër apo pesë bileta në një familje vërtetë s' është pak.

Më e keqja qe, se pasi u mbush edhe vëndi i fundit, pritëm shumë kohë e kur në palestër u paraqit primadona e tha: sonte nuk do të mbahej programi pasi diku në rrugën Shkup-Tetovë ka ndodhur ndeshja, dhe nuk dihej për fatin e musafirëve tuaj të

nderuar. Programin do ta vazhdojmë nesër, në ora 20. Kërkojmë falje dhe natën e mirë.

Të tërë të pranishmit, me kokat varë e lëshuan sallën, duke menduar ndoshta edhe për më të keqen.

Të nesërmen shumë kush pyette mos kishte dëgjuar gjë për fatin e musafirëve të pritur gjatë kohë. Në mbrëmje revolta arriti kulminacionin, pasi programi kishte filluar shumë më herët. E më tepër i ngjante një panairi se sa një programi të till. Sa kishte ulur (mbi 1200 vënde) ndoshta aq edhe në këmbë.

Nëse ka pasur aksident ne kërkojmë falje për këto vargje dhe u dëshirojmë shërim të shpejt, por nëse është bërë me qëllim përfitimi dhe manipulimi, atëherë gabimi s' mund ti falet organizatorit.

Do të ishte mirë sikur dikush nga "TRESHI PËRSHESHI" ta tregoj realitetin.

QEFINAT

Këto ditë në rrethin e Kërçovës u ndanë ndihmat humanitare, por jo në produkte ushqimore dhe veshmbathje, por në: QEFINA, KURORA, SAPUNA, PLUMBA…pra në THEQAFJE…???!!!

MUSHKOVSKI

Bisedojnë dy veta, njëri thotë tjetrit:

-Po ti hipi GOMARI PELËS thonë se del MUSHK, por ti hipi KALI GOMARICËS?- ai tjetri i përgjigjet:

-Vallahi unë s' di, por sipas atij ETNOLLOGUT që vdiq dhe këtyre si u thoni Ju të "MANU"-s ai duhet të dali MUSHKOVSKI???!!!

KU JANË MAQEDONËT?!

Pas bisedimeve te kryetari i Shtetit, duke dalë prej kabinetit të tij, kryetarët e partive-pakica i pyetën gazetarët për përqindjen e tyre në këtë shtet. Ai i turqve tha se janë afër 13%, ai i romëve tha se janë mbi 15%, pasi nuk ka qytet në Maqedoni, ku nuk ka romë, ai serbeve tha se janë afër 7%, ai vllehëve tha se janë afër 5%. Aty afër ishte një zotëri dhe një gazetar e pyeti:

-Ju zotëri cilën pakicë përfaqësoni? ai duke qeshur u përgjegj:

-Unë përfaqësoj atë BULLGARE! Por ne s' jemi të thirrur?!

-Mirë s’ ka gjë të keqe, por sa mendoni se jani?!Ai tha as më pak e as më shumë por sa SHQIPTARËT. Atëherë pak i nervozuar e pyeti gazetari:

-Atëherë zotëri KU JANË MAQEDONËT???!!! Ai duke qeshur i tha:

-Zotëri ata janë pak në PARTALLMENT siç i thonte Baca Salë, pak në QEVERI dhe pak më shumë në POLICI ME PAGESË…???!!!

KUSHTI I NUSES

Në takimin e fundit z. Nano u gjunjëzua përpara z. Berishë duke bërë kryqin dhe duke iu lutur, që z. Berisha kësaj here ti ndihmojë që ai Nano të bëhet President i Shqipërisë, përndryshe i vajti edhe nusja e re…???!!!

JO I MERITUAR

Në kafenenë “ÇARLI” në qendër të Tiranës, me një ton pak si të lart bisedonin ca njerëz për zgjedhjen e Presidentit të Shqipërisë, e njëri me një ton të nervozuar tha:

-Z. Ylli Popi është mjaft i respektuar në mesin e të respektuarëve, por për President të Shqipërisë ai nuk është i merituar…???!!!

GUTEN TAGË

Një torbesh përpara se të hyrte në një shitore i ra zilja e celularit. Ia filloi bisedës në gjuhën torbeshiane dhe sipas asaj që dëgjuam, ai flitëte me të motrën në Gjermani. Pas pak e pyeti për të birin dhe pas pak dëgjuam fjalët –GUTEN TAGË-.

Pas bisedës me të nipin prap e filloi bisedën me të motrën, por tash duke i thënë:

-Motër nipin të ma mësosh të flasi në gjuhën maqedone në atë gjuhë të ëmbël të nënës.- pastaj hyri në shitore dhe përshëndeti me një përshëndetje turke apo arabe as dreqi se mori vesht. Njëri nga të pranishmit e pyeti ç' ndihej ai me kombësi, ai shumë krenar i tha se është turk, por ai nuk e la me aq, por i tha si mundet të jetë turk, kurse si gjuhë të ëmbël nëne paskan maqedonoshkinishten…???!!!

DOLLARËT

Këtë vikend rrugës së qytetit ecnin duke biseduar dy persona me nam në politikë. Njëri i thonte tjetrit:

-Në këtë kohë të pa kohë, si nuk patëm edhe ne një Millosheviq që me shumë qejf do ta kishim

dorëzuar në Tribunalin e Hagës, ndoshta edhe për çerekun e dollarëve që do të marrin serebet. Ai tjetri i përgjigjet:

-Ne i kemi, por akoma është herët, ndoshta vitin 2002 do ti kemi pesë apo gjashtë persona, por s' di sa do të jetë çmimi i tyre?!

GJARPËRI ME NJË SY

Millosheviqin, pasi e morri gjumi i rehatshëm në shtratin e qelisë në burgun e Tribunalit të Hagës, në ëndërr u gjind në Gazimestan duke mbajtur një fjalim epokal. E dimë se prej aty hipi në PIEDESTALIN politik. Në dorë paska mbajtur shtizën e flamurit, por një gardian e paska mbyllur derë pak si me forcë dhe Millosheviqi është zgjuar dhe e paska ndezur dritën, dhe sheh se te dera paska një GJARPËR ME NJË SY! I habitur i thotë:

-Po ti ç' kërkon këtu?! Ai përgjigjet:

-Hë po ne jemi të një gjaku dhe politike. Plumbave u ikëm por Hagës jo. Dije do ta kemi pak vështirë, por këtu do të jemi të sigurtë???!!!

SPIUNI I DYFISHT

Kalosh Çeliku e thirri autorin e librit “ZOTI ËSHTË KUDO” që të pinin ka një birrë të ftohtë në Restorantin “ELITA”.

Sa u ulën bënë porosinë, dhe pa i bërë as dy fjalë kamarieri ua mbushi gotat, ata i kapën në dorë dhe pa thënë gëzuar, përpara u doli një njeri mjaftë pedant me një gjysmë ÇALLME në dorë. Pa i përshëndetur i tha autorit të librit:

-Do të thotë se ne me PETICIONIN nuk gabuam! E një që ishte ulur aty afër, po ashtu iu drejtua autorit:

-Mos i vëndoni veshin Zotëri, pasi ky është SPIUN I ZOTIT. Kësaj bisede iu bashkuan edhe një tjetër i ulur në atë tavolinë i cili tha:

-Jo vetëm i Zotit, por edhe i POLICISË…?!

PËRRALLAT E MAQEDONISË

Yllëza e vogël, pasi e lexoi “FLAKËN” iu drejtua babit:

-Babi duket se ky libri i botuar kohë më parë me “PËRRALLA TË MAQEDONISË” duhet të jetë mjaftë i mirë pasi BALLINA paraqet (SHTRIGËN), pra vetë MAQEDONINË…???!!!

DYSHI DHE PESA

Arsimtari i gjeografisë e pyeti Bitin:

-Biti, ku kanë jetuar, apo i gjejmë sot shqiptarët dhe sllavët apo më mirë ta kuptosh pyetjen maqedonët?! Biti i përgjigjet:

-Zoti arsimtar, pasi tani është nxehtë shqiptarët mundemi ti shohim rreth liqenit, rreth bregdetit, nëpër ara, por i shohim edhe nëpër male, e sa u përket sllavëve, ata të rehatuarit i shohim vetëm në HAG…?!

-Bravo Biti për lëndën e gjeografisë dysh, kurse për politikë Biti një pesë me hënë dikur i thonim…???!!!

PATRIOTIZMI

Mësuesja e pyeti Bitin:

-Biti ç' është PATRIOTIZMI? ai përgjigjet:

-Shprazja e qytetit sa hap e mbyll sytë mësuese…?!

LAJMËTARJA

Biti i tha mësueses:

-Mësuese ju ikët ne humbëm shumë orë mësimi! Ajo i përgjigjet:

-Biti unë nuk ika, por shkova të lajmëroj se do të fillojë lufta…!

DIALOGU

Kurrë s’ pranon dialog i forti në shtetet demokratike e ku më në Maqedoni…!

KUJDESI

Biti i pyeti shokët:

-Sa kujdeset për ne mësuesi shokë?! ata përgjigjen:

-Lali, sa kryetari për shtetin.

-Sali, sa gjenerali për ushtarët.

-Mali, sa fusha për bereqetin.

-Sija, sa livadhi për lulet. Pastaj Biti u tha:

-Jo jo shokë, por ai kujdeset sa ajo Lica për këlyshët që i polli na i solli në oborr të shkollës dhe iku…?!

BAM, BAM, E PRAPË BAM

Sikur edhe Ju ta takonit plakun në rrugën e një katundi, plotë baltë, të ngushta e pa rrymë elektrike me siguri rrudhat e tij do t; ju shtynin të ndërroni ndonjë fjalë. Kështu pasi biseduam disa minuta, s’ di ç’ mu kujtua ta pyes për emrin dhe moshën. Plaku qeshi dhe tha:

-Më thonë LALA TAUL, e sa për vjetët-llogaritni vetë. Pa një bëhem me tre numra, siç thoni ju shkollarët!

-Po lala Taul, ç' mund të thoni për jetën, për kohën e kaluar që e keni si në pasqyrë?

-Kohët po ndryshojnë. Në fillim më thirrnin Aga Taul. Pastaj Taul beg, më vonë shoku Taul, e tash më thonë zotëri Taul. E unë bre bir, pasi kam parë shumë, po frigohem mos ndodhë si deri tash aga Taul e bam. Taul beg e bam, shoku Taul bam e tash zotëri Taul e prap bam shpinës!

Kini kujdes…, qe fjala e fundit e xhakës Taul.

INTELEKTUALIZMI

Intelektualizmi i madh të tërë shqitarëve ua solli robërinë:në Kosovë,në Maqedoni dhe ja tani edhe në Shqipëri.Ç'është më e keqja se ata akoma nuk binden se ndër shqiptarë nuk ka intelektualë!

Ja gabimi më i madh,për ta hek robërinë ata intelektual kanë zgjedhur intelektualët më të mëdhenjë:serbomanët,maqedonomanët,italianomanët dhe ajo më e keqja për çlirimin e tërë shqiptarëve janë mbështetur në grekomanët?!

Zot Ju lutemi fëmijëve që lindin shqiptarë futu pak më shumë tru në kokë…?!

KLANDESTINËT

Një grup klandestinësh shqiptarë kishin bërë një padi në Gjygjin e Hagës kundër shtetit të Italisë.Policia italiane gjatë dëbimit të tyre kishte përdorur një dhunë të paparë!

Dhe ja erdhi dita që të dalin ballë për ballë në Gjygjin e Hagës.Klandestinët shqiptarë kërkonin një shumë marramendëse parashë,si dëmshpërblim,përçudi pala italiane pohoi me kokë se pajtohet.Klandestinët shqiptarë po ashtu e bindën gjygjin se policia italiane nuk ishte sjell një lloj edhe me klandestinët tjerë,që sishin shqiptarë.Bile edhe shumë akuza të tjera,që të tëra policia italiane i pranonte me lëvizje të kokës si shenjë pohimi.Atëhere gjykatësit pyetën:

-Atëhere pse jeni sjellur aq brutalisht vetëm me shqiptarët?!Përgjigjja ishte shumë e shkurtër!

-Jemi sjellur dhe do të sillemi,bile edhe më keq!

-Ja zotëri gjykatës ju e dëgjuat vet,se ne kemi të drejtë thanë ca klandestinë.Ju lutemi qetësi thanë gjykatësit.Atëhere njëri nga karabinerët tha:

-Vetëm Ju shqiptarët dini të shkatërroni pasurin e Juaj!dhe vazhdoi:

-Ju lutemi zotërinj gjykatës cili popull në botë ka shkatërruar shkolla,universitete,spitale dhe biblioteka

të tëra,vlerën më të madhe të një kombi,po ashtu edhe shumë arrkiva të shtetit.

-A është kjo e vërtetë zotërinjë klandestinë? pyeti njëri nga gjykatësit!

-Dikush tha po,por pse mërziten aq shumë karabinerët italian për pasurinë tonë kombëtare,kurse ne vetë s'mërzitemi!

-Atëhere njëri nga gjykatësit tha:Ju të nderuar policë të silleni edhe aq më egër se kolegët e juaj,dhe për kësi egërsirash s'ka vend nëpër burgjet tona dhe sa më shpejt të dëbohen nga vendi…?!

DËNIMET NGA ZOTI

Një funksionar nga ish Jugosllavia,akoma komunist pasi ai për çdo ditë ia miklon zemrën,ne nuk do të themi se është tradhtar,por me mjaft përgjegjësi do të themi se nuk është serioz dhe i sinqert në biseda dhe premtime.

Rastësisht në bisedë me autorin e veprës fetare "ZOTI ËSHTË KUDO" e para e këtij lloji në këto treva i premtoi se ai me mjete të shtetit do t'ia botojë

atë vepër.Pas ca ditësh ai ndërroi mendimin dhe harroi premtimin ashtu siç e kanë zakon komunistat.Autori u dëshprua pak,por ç'të bënte,përveç që të pritte ditë më të mira.
Jo seriozitetin e tij e dënoi Zoti me një tragjedi,që me të vërtetë neve na vjen shumë keq.

Autorit për të njejtën vepër i premtoi mjete për botimin e saj një bashkëvedas i punësuar në perendim dhe mjaft pasanik,me një rrogë të tij mundej të botoheshin afër dhjetë vepra të tilla.Por ndodhi si me të parin,pasi edhe ky komunizmin e ka në zemër.Edhe këtë Zoti e dënoi me tragjedi familjare,që neve po ashtu na vjen shumë keq.

Për të njejtë vepër fetare autorit i premtoi mjete një ish shok klase,por me tapi marksist-leninist,i punësuar në perendim dhe shumë pasanik,edhe ky në momentin e fundit e ndërroi mendimin,duke i thënë:më mirë do të jetë sikur ato mjete ti shërbenin për ndërtimin e stallës së kafshëve se sa për harxhime të tilla.Edhe meqenëse ai kur s'ka pasur,ska dhe s'do të ketë nevojë për asi stalle pasi s'ka dhe s' do të ketë kurrë kafshë.

Autori duke qeshur i uroi sukses në ndërtimin e stallës.Por Zoti nuk kishte thënë që ato mjete të harxhohen për stallë.Ai u bind edhe vet,pasi ditën ndërtonte ajo natën rrënohej,tamam si "Temelura".

Autorit njerëzit e mirë por me siguri më të vobekët se të parit,por me zemër dhe shpirt si për

komb ashtu edhe për fe jo vetëm që ia financuan ato vepra,por edhe disa të tjera…

GJENIU I SHEKULLIT

Fëmijën që e shpalli z.Frçko si të vdekur ai jo vetëm,që jeton,por ai shumë para kohe e mbaroi shkollimin dhe bota e shpalli si –GJENIU I SHEKULLIT-.Tash ai arsimon njerëz që janë me nam.Z.Frçko dëshiron të takohet me ta dhe të bisedojë,por ata s'ulen me te pas ai s'është i nivelit të tyre …

ZHGËNJIMI

Një mik e pyeti Millosheviqin:

-Ç'menduat kur vendosët ti dëboni shqiptarët nga Kosova?!ai përgjigjet:

-Isha i bindur se shqitarët janë si uji që rrjedh,pra ata kurrë s'do të ktheheshin më…?!

LOJALITETI

Gjersa e tërë bota përkrah kosovarët kundër Serbisë,ca shqiptarë lojal ndaj Beogradit përkrahin Serbinë kundër tërë botës…?!

HAXHILLËKU

Jellcini shkoi në Jerusalem në haxhillëk me qëllim që të ngeli atje si njeri i shenjtë,por në takim me Jezu Krishtin ai s'mundi të thonte asnjë fjalë,atëhere Jezu i tha:

-Ti qenke dejur me Votkë të eger ruse e jo me gjakun tim…!

EDUKIMI

Sllavët nëpër shkolla heterogjene edukohen në frymën njerzore,por pastaj shkojnë nëpër shkolla homogjene që të edukohen të sillen tamam si bisha ndaj të tjerëve,veçanrisht ndaj shqiptarëve.Atë edukim ua jep qeveria,por edhe feja e tyre ortodokse…?!

KRIMINELËT

Kriminelët nuk e njohin DREJTËSINË,por DREJTËSIA i njeh ata prandaj ndodhen në HAG…?!

NGUSHËLLIMI

Këto ditë shkruan gazetat se një grupacion nga gjiri i vet e paska larguar një antar si non grata,por realiteti qenka se ai se pranonka atë grupacion si të tillë…?!

FUNDAMENTALIZMI ORTODOKS

Sipas një burimi tepër sekret e ashtuquajtura MANU paska mbajtur një mbëledhje me dyer të mbyllura,dhe paska marrë një vendim ,që nëpër minaret e gjysmuara nga lufta barbare sllave të vëndojë edhe kryqet ortodokse…?!

Ajo bëhej me qëllim që bonorët e atyre fshatrave të tregojnë lojalitet ndaj shtetit Maqedon duke treguar një urrejtje të pa parë ndaj UÇK-ës.Dhe vetë bota të bindet se shqiptarët duan që shteti të ngeli si SLLAVO-MAQEDON…?!

VARREZAT MASIVE

Para ca ditësh një ekspert për Varreza Masive pranë Tribunalit të Hagës,për një gazetë perendimore tha:

-Prej burimeve tepër sekrete kemi dijeni se në Maqedoni nuk ka Varreza Masive,por paska thasë të mbushur me eshtra të vdekurish,që ruhen nëpër frigoriferë lëvizës,që për disa orë ato i gjen edhe në qendër të Shkupit e jo më nëpër fshatra të Sharrit…?!

NOFKA DELE

Këto ditë bisedova me një plak në lidhje me kopetë e deleve,pasi ai tërë jetës ka qenë bari i përsosur.Në fillim ai u habit,por kur kuptoi qëllimin me kënaqësi ia nisi bisedës:

-Në kopenë time kam pasur gjer në pesqindë krerë dele.Përherë kur kopesë i printe ndonjë dash,dita më shkonte mbarë.Në kope kam pasur edhe dele kryeneçe,që shumë herë kanë dashur ti prijnë kopesë.Ato ose e drejtonin kopenë në drejtim të ujkut ose në drejtim të arave që të bënin zullum.Prandaj ky Spira i Partallmentit siç i thotë baca Salë,që paska

nofkën dele,mundet të jetë BURR-GRUA,prandaj edhe shteti shkon nëpër rrugë qorre…?!

VENDOSMËRIA

Një funksionar i lart në Kabinetin e Jaser Arafatit,në një bisedë me gazetarë tha:

-Ne kemi VENDOSUR ose shtet Palestines me kufinjtë e viteve para l977-ës,ose vdekje për tërë Palestinezët,por le ta dinë të tërë se kurrën e kurrës mbi tokë s' do të ketë shtet Izraelit…?!

TUTELA

Para ca ditësh një parlamentar i Parlamentit të një ish republike Sovjetike tash për tash le të ngeli sekrete,në Parlamentin e vet tha:

-Kjo Rusia e sotme në kohën e fundit shumë ka hapur gojën dhe pa marre pa ndal akuzon Shqipëtarët për një Shqipëri të Madhe,apo për një Kosovë të Madhe!S'di si s'turpërohet kur i thotë ato fjalë,kurrë s'bëhet shteti i Madh me popullatën e vete.Ajo vlen edhe për Shqipërinë edhe për Kosovën.Shtete të mëdhaja ishin Serbija dhe Rusia kur nën TUTELËN e vet i kishin futur edhe ato KOMBE,që me ta s'kishin asgjë të përbashkët…???!!!

DONATORËT

Pas miratimit të Amandamenteve për ndryshimin e Kushtetutës,Qeverisë së Maqedonisë i erdhën shumë urime dhe përkrahje,me telegrame dhe letra,prej shumë shtetesh dhe DONATORËVE të huaj,që ti ndihmojnë kësaj popullate të rraskapitur.Është interesant se në tërë letrat dhe telegramet përmbajtja ishte e gati e njejtë.

Së pari në arkën e shtetit të kthehen paratë e vjedhura,nga funksionarët Maqedon.Ata të dënohen,të mbyllen ose ti dorzohen Tribunalit të Hagës,pasi ato vjedhje janë më tepër se TERRORIZËM.Interesant çdo kund cekej se ato vjedhje janë bërë me qëllime nga hisja që u takon Shqipëtarëv,edhe ate për punësim dhe shkollim,e veçanrisht për Univerzitetin e Tetovës…

PORTA E SHENJTË

Para ca ditësh një grup gazetarësh,me ca teologë maqedon u drejtuan në drejtim të Portës së Shenjtë në Vatikan për tu ankuar se “vandalistët shqiptarë”bëjnë rrënimin e objekteve fetare ortodokse.Pasi u lajmëruan dhe treguan qëllimin e asaj vizite,njëri nga

Porta e Shenjtë u tha se të nesërmen do të jepnin një konferencë shtypi.

Të nesërmen njëri nga Kardinalët e Papës kompetent u paraqit në sallën ku e pritnin gazetarë nga e tërë bota.Ai qysh në fillim dukej pak si i nervozuar,prandaj pa humbur kohë,dhe duke mos lejuar që gazetarët sllavo-maqedon të bënin ato pyetjet e tyre provokuese ia nisi:

-Papa dhe ne dënojmë ashpër prishjen e Objekteve Fetare në IRJM.Sipas raporteve zyrtare të organizateve kompetente botërore atje janë prishur dhe shkatërruar mbi pesëdhjetë xhami,dy atri kisha dhe një manastir.Xhamijat i ka shkatërruar Policija dhe Ushtrija Maqedone,tash për tash qëllimin e tyre nuk e dimë.Kishat dhe manastiri janë rrënuar,tash për tash qëllimin dhe rrënimtarët nuk i dimë.Sidoqoftë ne i dënojmë edhe këta,edhe pse nuk dihen,por më së shumti i dënojmë ata që i dimë…?!

GJYSËM KRYETARLLËKU

Për gjysëm kryetarllëk z.Ibro,pak para Bajramit të Madh pranoi Urimin e parë prej Zonjës së tretë të Osama bin Lladenit.Sa kapi me dorë pakon z.Ibro filloi ta hapte,pasi ishte hera e parë që Posta e Kosovës sillte një dërgesë nga Avganistani i largët.Por dikush i tha:

-Prit z.Ibro ndoshta është ndonjë dërgesë Antraksi!Nuk shkuan as pesë minuta,arritën ekspertë të vendit dhe nga tërë bota.Shpejt vërtetuan se s;kishte të bënte me Antraks,por ishte vetëm një Urim për gjysëm kryetarllëk.Në pako kishte vetëm një Shami mbulesë koke dhe fytyre me ngjyrë të zezë ku në mes të shamisë ndodhej një shpend i kuq.Në njërin skaj shkruante në shumë gjuhë të botës:-PËR BURRAT E KOSOVËS-

JU JENI TERRORISTA

Para ca ditësh Kërçovën e vizituan ca gazetarë të MTV-ës,në mesin e tyre ndodhej edhe ai serbi i shndërruar në sllavomaqedon i ashtuquajtur me nofkën TOKMAK.Nëpër Kërçovë bënë shumë intervista provokuese,rastësisht në një rrugë takuan xha Bitin.Ai Tokamku iu afrua dhe i bëri shumë pyetje provokuese si shumë të tjerëve.Njëra ishte:

-Xhaxhi Ju lutemi tregona si kaloni me terroristat dhe a janë të shumtë në numër në qytetin tuaj Kërçovë?!Xha Biti me atë stilin e vet iu përgjegj:

-Nëse duhej dikush të përgjigjet sipas qejfit tënd,atëhere ti duhej të intervistosh atë kolegun tënd të xhveshur nga kombi apo siç i thoni ju:Tallas,Fallas apo Llatas.Kurse unë do të tregoj se në qytetin tonë s’ka pasur dhe s’do të ketë terrorista,për ato që

mendoni ju.Por ja sot në qytetin tonë paskan hyrë terrorista.Atëhere ai Tokmaku i nervozuar i tha:

-Pse na numron neve ne s'jemi terrorista!!!pastaj xha Biti me shumë ters i tha:

-Vetëm ju jeni terrorista…?!…

MË I KOMPLETUARI

Dikur në një shoqëri intelektualësh,ku prezent ishte edhe ai Drr.Limanovski,dikush pyeti:

-Kush prej nesh është më i "kompletuar"?!dikush nga ata të pa prerit tha:

-Drr.Limanovski,pasi ky si gjuhë hamamtare ka shkinishten si na thonë ata të prerit,për fe pranon Islamin,kurse si komb,shkon livadh më livadh si ai veshgjati…?!

POPAT

Ca popa maqedon,në një takim me ca koka botërore thanë:

-Ju s'keni ç'bisedoni me politikanët maqedon për emrin e shtetit tonë.Grekët neve duan të na thërrasin si Maqedoni e Epërme,ne Greqinë do ta thirrim si Maqedoni e Poshtme.Ata duhej ta dinë se kur ka qenë Maqedonia ata s'kanë egzistuar!

Atëhere botërorët i kapën kokat me dorë,kurse njëri kokës ia vëndoi gishtin…?!

INDOKTRINIMI

Në një takim me gazetar Gospodin Kirillin ndër të tjera e pyetën:

-G.Kirill,ç'mendoni për shkatërrimin e Manastirit të Leshkës dhe të Reçicës së Vogël?ai përgjigjet:

-Ata janë të rinjë shqitarë të indoktrinuar nga fundamentalizmi Islam,prandaj ajo rini duhej të zhduket!por një tjetër e pyeti:

-Z.Kirill,ç'do të na thoni për shkatërrimin e mbi pesëdhjetë xhamijave?G.Kirilli përgjigjet:

-Unë nuk kam në dijeni se në Maqedoni ka aq xhami,ku më të shkatërrohen aq sa thoni Ju!Ju dhe të tjerët duhej ta dini se në këtë nënqiell Zoti është maqedon bile edhe Ortodoks…???!!!

LLAZO-TITO

Vikendin e kaluar në Konakun"Shën Maqedoni Rrenc"u mbëlodh i tërë Kreu Maqedon pozitë dhe opozitë,dhe mbajtën një mbëledhje me dyerë të mbyllura dhe sollën disa vendime:

1.Llazar Kolishevski të shpallet tradhëtar i kombit Maqedon,kurse Josip Broz Tito të shpallet si gjakpirrës i maqedonasëve.Këtë vendim e sollën,pasi kurë se realizuan 'MARRËVESHJEN'e pas L.N.Ç,që shqiptarët e Maqedonisë Perendimore të shpërngulen në Maqedoninë lindore,kurse bullgarët dhe një pjesë e maqedonëve ti sillnin në Maqedoninë perendimore.

2.Kurrë shqiptarëve të mos u lejohet të ndërtojnë shtëpija me materijale të forta,por vetëm disa baraka druri ose mure balte.

3.Maqedonija të shpallet"Shtet i Shejnt"-BIBLIK.

4.Këto vendime të votohen edhe ate në se ka nevojë me dhunë në Partallmentin Maqedon-siç i thot Baca Salë-deputeti,edhe ate përpara vitit 2oo2…?!

TESHAT-DEKORATIVE

Në një shtet Evropjan në një konferencë shtypi,ku përpara gazetarëve ndodhej edhe z.Shtuli,një gazetar i bëri një pyetje:

-Z.Shtul,pse Univerziteti i E.J.L apo siç i thonë edhe Univerziteti i Juaj,filloi me vonesë afër dy muaj,patët probleme të natyrës teknike apo të asaj politike?Shtuli pasi u mendua pak ia nisi:

-Ju pasi e parashtruat këtë pyetje dukej se jeni mirë të informuar.Prandaj unë do të jem i shkurt në përgjigje dhe i sinqert.

Vonesa ishte e karakterit politik.Qeveria e Maqedonisë dhe dy rektorët e univerziteteve të maqedonisë ishin të një mendimi dhe asesi të lëshonin pe,që edhe ky Univerzitet të ketë rektorin e vet,por ai të jetë nën Ombrellën e Rektorit të Univerzitetit të Shkupit,që të mos bëhej FEDERALIZIMI I MAQEDONISË siç i thonë ata.Kur panë se nuk gjunjzohemi ne dhe u caktuam një datë ULTIMATUM,ata na dërguan një farë letre ku thonin:

-Teshat DEKORATIVE të rektorit të këtij Univerziteti të mos jenë të njejta si ata të dy Univerziteteve maqedone-pra kjo ishte një e ashtuquajtura letër NGUSHËLLIM I MJEGULLUAR.Pastaj letra vazhdon:Shteti i Lavarur-më falni i pavarur MËKËDON kurkush nuk mundet ta shtyjë që të pranojë DIPLOMAT E KËTIJ UNIVERZITETI…?!

PESHORJA E DREJTËSISË

Për të kapur në dorë-Peshoren e Drejtësisë-duhej plotsuar disa kushte:të jesh i dëgjueshëm,të dish dhe kuptosh gjuhën politike,të kesh gjak gjarpëri

Karpatesh,të kesh vesin e –VINO ZHITOS-dhe viktimës ti thuash TERRORIST…?!

ANDEJ E KËNDEJ KUFIRIT

Si çdo luftë ashtu edhe ajo e L.N.Ç i ka të mirat dhe të këqijat e veta.Vëndoi kufirin aty ku s'duhej,hidhëroi vëllaun me vëllan,ndau motrën me vëllan e shumë e shumë të zeza të tjera…

Këtë fat e pati edhe familja BRAJA-këndej Brajoska.Motra andej vëllau këndej.Dikur takohen,por nën kontroll policor dhe me përkëthyes,edhe pse prej një nëne e babe e të rritur afër njëri tjetrit afër njëzet vjet,dhe kishin folur vetëm shqip,bile as kishin ditur shkinisht.Por politika, pasuria dhe policia thonë ta ÇAKËRRDISIN trurin.Në kufirin ndarës ,motra duke zbritur prej veturës,tepër lluksoze i thotë të vëllaut:

-Të falimenderit vëlla për dhuratat,Ty shtetit tënd,dhe të lumt për pasurinë që kishe,por unë jam më e pasur se ti,pasi kam pasurinë që ma ka dhënë Zoti dhe prindërit tonë të përbashkët,që më s' janë në mes të të gjallëve.Të lutem merri prap dhuratat jepja shkinës që të pajtoheni,unë të premtova se do të shkoj te varret e prindërve…?!

PYTËSORI

Z.Novkovski ministër i arsimit këto ditë lëshoi një pytsor,për nxënësit e ciklit të ulët,edhe ate vetëm me një pyetje dhe një tjetër pyetje urdhëresë:

-Ç'do të bëheni kur të rriteni dhe vizatoni diçka për profesionin e juaj të ardhshëm?!Interesant se mbi nëndëdhjetë për qind të nxënsëve ishin përgjigjur se kur të rriten do të bëhen policë.Po ashtu u panë edhe vizatime të llojllojshëm,por më së tepërmi:revolverë,kallashnikovë,bomba dore,helikopterë me koka derri,automatike dhe…

FUNDAMETALIZMI ORTODOKS

Pasi kryeministri dhe ministri i punëve të mbrendëshme emëruan ca gjeneralë-policë dhe ata i përgëzoi edhe popi më i madh i Maqedonisë,bota u bind se në këtë shtet kurgjë s'ka në rregull.Ca njerëz me autoritet për këtë gjest jo normal,kërkuan edhe mendimin e Papës në Vatikan.Papa mjaft i befasuar dhe i revolltuar tha:

-Tash më jemi të bindur ashtu si e tërë bota,se në Maqedoni dhe në disa shtete të lindjes fundamentalizmi ortodoks vepron haptas kundër njerëzimit.Ne kemi bërë shumë mëkate duke i akuzuar shqiptarët për fundamentalizëm Islam…?!

BALLOJA E LUGETËRVE

Në ballon e lugetërve dikush bëri një pyetje,që prej saj u zbulua edhe sekreti.Pasi asaj pyetje s'dinte askush ti japi përgjigje,apo ata e ruanin sekretin dhe ashtu heshtnin.Dikush nguli këmbë,që me çdo kusht asaj pyetje ti jepej edhe pëgjigje.Ashtu Kryelugati e thirri ekspertin më të madh të shtetit.Ai pasi mori garancën se nuk do të ketë pasoja tha:

-Të tërë ata njerëz që fillojnë të mirren me politikë së pari duhej të humbin ndjenjat njerzore,pastaj atyre u shtohej oreksi për punë,por po ashtu ata humbin aftësitë dhe dalëngadalë atyre u shuhet shqisa e të nuhaturit.Prandaj ne dhe ju jemi të etshëm për gjak dhe shndërrohemi në lugetër…?!

KUFIRI I SHTULIT

Në parkun e qytetit ishin ulur ca pleq,dhe komentonin shtypin e ditës.Sipas gjuhës që flitni shihej kjart se të tërë ishin sllav karpatesh,ata edhe në bisedë ishin shumë serbes,pa asnjë droje.Dikur njëri u tha:

-Për ne është shumë mirë që bota e angazhoi z.Shtulin,pasi ai i dinë mirë punët tona me shqiptarët dhe ai është mik i ynë.,bile edhe i vjetër.Po ashtu ai ka një autoritet në botë,por dhe te shqiptarët.Atëhere ndërhyri një tjetër,një thinjush i tërbuar:

-Po,po keni të drejtë,e kemi mik të vjetër,pasi ti dhe Qeverija jote i keni sytë e mbyllur,nga pluhuri i kohës dhe truri i juaj i mykur.A nuk e shikoni se si ne e bëri sherrin?!

Në mes të Tetovës në tokën maqedone na e vëndoi themelin e Univerzitetit të shqiptarëve.Dhe prap shqiptarët nuk janë të kënaqur.

E ju me Qeverinë e juaj e quani fitore të Maqedonisë.Ai miku i juaj dhe armiku i shqiptarëve që thoni ju,ndoshta nesër do të na e vëndojë edhe kufirin përmes të Maqedonisë…?!

KLIME VELEMUTOVSKI

Në Kongresin Gjithë Maqedon,Shqipërinë e përfaqësoi njëfarë njeriu me nam e nishan,shqipëtar

me emër e mbiemër bile edhe musliman.Dorën në zemër këtë biçim njeriu e pritën me shumë nderime,bile edhe vet një SHOP e një POP mjekërr gjatë,por sy shkurtër.

Sa u prezentua ai Biçim Njeriu me emër e mbiemër,Shoporovi dhe Poporovi si u konsulltuan pak i thanë se prej sot do të jetë,sipas emrit dhe mbiemrit më afër dhe më i përshtatshëm emrit dhe mbiemrit janë fjala për emër Klime e për mbiemër Velemutovski,ai me kënaqësi u përkul përpara popit dhe iu kthye turmës duke u rënë duarëve,por pa mos i bërë as tre a katër hapa Shoporovi i tha që të kthehet,pasi edhe pse ia ndërruan emrin ai ndoshta prap do të ngeli musliman.Atëhere popi i urdhëroi që të lëshonte pantallonat poshtë.Klimja u gjind në gjendje jo të mirë,por urdhëri është urdhër e veçanërisht kur të urdhëron një pop sllav.I lëshoi pantallonat ata prej pas e pështynë,kurse poporovi i tha Shoporovit ky qenka “POTSEKUSHKO”.Shpejt shkruaja udhëzimin për në kirurgji.Atëhere ata që ishin të angazhuar për mbajtjen e rendit e morrën dhe e dërguan drej e në sallë të operacionit,që për asi rastesh përherë është e gatshme.

E sollën një frigorifer të vogël,e hapën me shumë kujdes dhe nxorrën një copë lëkure ortodokse,ia qepën dhe e nxorrën prej salle si operacion shumë të suksesshëm.Nuk vajtën as pesë minuta shëndeti i Velemutovskit u keqsua,që pas ca minutash dhe

vdiq.Atëhere e lexuan pusullën që ishte në frigorifer dhe u bindën se ajo copë lëkure kishte qenë e infektuar me SIDË.

Me shumë nderime kufomën e përcollën për në Shqipëri,por matanë kufirit patën probleme,pasi kufomën nuk e pranonin ata të familjes,pasi ajo nuk ishte në rregull,ate e hetoi dhe e vërtetoi gruaja e vet.Këtë kur e kuptoi imami,por edhe prifti shqiptar s'deshtën as ti afrohen dhe të japin leje për varrim në varrezat e tyre.Atëhere i pari i atij vendi tha:

-Që të mos qelbet i tëri ky vend le ta varrosin atje ku i varrosim bagëtitë dhe derrat e ngordhur.Sa e bënë varrin mbi varr e bërri shurrën një qen,por në realitet një qen i çuditshëm,që edhe folte me gojën dhe trurin e atij ETNOULLOGUT,besoni se edhe koka i ngjant atij.Pasi u largua qeni,ata që u afruan panë se kishte shkruar:-PREJ KËSAJ FARE S'KA DOBI ASKUSH-…???!!!

ÇMENDURIA

Këto ditë një njeri i botës me shumë autoritet tha:

-Të gjithë Sllavët janë të çmendur nga fundamentalizmi ortodoks,por më së tepërmi dallohen pushteti dhe rinija maqedone…

BOSHKOVSKI

Shokut Boshkovski këto ditë i erdhi një thirrje për të vizituar Amerikën,por jo si ministër as si ekspert lufte,por vetëm si një artist diletant…?!

KORRJE-SHIRJE

Korrje shirjen do ta bëjë NATO,por kush do ti hajë gatimet…?!

ÇARMATIMI

Çarmatimin e U.Ç.k-ës do ta bëjë NATO,por kush do ta bëjë çarmatimin e të çmendurëve maqedon…?!

HELMIMI

Sa mëkat ka bërë ai që deshti të helmojë z.Kapllan Resulin?!Por më shumë mëkat bëri ai që deshi të na helmojë dhe na helmoi,neve mbi dyzet KRIJUES në Strugën e poezisë,edhe ate në

Akademinë Përkujtimore të Mehmedali Hoxhës.Poeti i nderuar shqiptar z.Odhise Grillo i tha poetit të respektuar z.Rifat Kukaj:

-Ç'të keqe bërëm,që na e bërën këtë të zezë more Rifat…?!

NOBELLOVACAT

Pak para ca ditësh disidenti Adem dhe kryetari Ibro patën një takim kosultativ dhe tepër sekret.Takimi u realizua me kërkesë të disidentit,që përherë ka dashur bashkëjetesë dhe siç tha se në zemër qenka multiteknik.Pastaj i tha z.Ibros:

-Ne të dy jemi afër Çmimit Nobel,prandaj duhej këta në veri të kenë më shumë liri se shqiptarët,ashtu ne do ta kemi përherë hapur atë rrugë për te vëllezërit në Beograd.Shqiptarët duhej ta kuptojnë se kurgjë s'është Kosova si shtet dhe tërë shqiptarët në krahasim me dy " NOBELLOVACA"…?!

FENOMENI

Çdo shqiptar donë vetveten dhe armikun,por asesi mikun dhe të afërmit…?!

MASKIMI

Ata që pispillosen me tesha të bukura dhe parfymosen me parfyme,maskojnë shpirtin e qelbosur…?!

BRIZHIT BARDO

Një gazetar e pyeti Brizhit Bardon
-Pse Ju zonja Bardo më shumë kujdeseni për kafshët dhe i doni më shumë se njerëzit?ajo përgjigjet:
-Pasi unë bile edhe shumë të tjera në kohën e fundit gati asnjë fëmijë më s'afrohet te gjiri i nënës…?!

LITARI

Për habi në çantën e krijuesit të madh përveç ca librave ndodhej edhe një litar…?!

PERSONAZHET

-Alo
-Alo,urdhëroni…

-Xhaxhi unë jam Biti.

-Hë Bit urdhëro,çfarë ka ndodhur?!

-Më falni është shumë vonë,s'ka ndodhur gjë.Jam duke lexuar një roman të një autori"shqiptar",por personazhet janë të tërë sllav?!

-Mos u mërzit more Bit se ai është një autor nga ata që u thonë OBORRTAR.Ata veprat i kanë shkruar me porosi,apo aspak si kanë shkruar vetë,por dihet se janë shpërblyer shumë mirë…?!

-Xhaxhi mos kanë dashur që në letërsinë shqipe të fusin elemente të huaja…?!

-Bit unë prej kur kam hetuar se ti mirresh me politikë,por kurrë s'kam menduar dhe hetuar se ti merresh edhe me SHKENCË…?!

MOHIMI

Një funksionar i vogël mohonte një poet të madh?!Pas mandatit funksionari ngeli zagar kafenesh kurse poeti vazhdoi përpjetë.

SHARLATANI

"Poeti","Shkrimtari","Shkencëtari"…bile edhe më tepër,kurrë si ka pranuar shkrimtarët kërçovar,bile

as Klubin e tyre.Më vonë kuptuam se ai paska dashur që ti udhëheqi ata…?!

AKUZA

Për një gabim të vetin,baba e akuzonte të birin.Por siç thuhet në popull:”Drejtësia vonon, por s’ harron”.Erdhi dita të dalin përpara Drejtësisë,dhe pas shumë peripecive,gjykatësi më në fund i tha prindërit:

-Djali i Juaj duhej të heshti përpara Jush,por jo edhe Drejtësia or matrapaz…?!

BOZA NË FYT

-E paske ngarkuar pak si tepër magarin Sulo!

-Ç’të bëjë Shyto,për këtë e ushqej,edhe këtë javë e pastaj vjen djali me Benc.Shpëton magari shpëtoj edhe unë.

-Ç’kishim nga Kërçova unë s’kam qenë disa javë!

-Tollovi Shyto tollovi.A të kujtohet ai kaurri shefi i “kamenollomit”?!

-Po si jo more Sulo,a sa i poshtër që ishte,s’na linte
edhe bukën ta hamë rehat.A s’dinte emrin e vet ta shkruaj.

-E takova përpara Nafizit,më mori me zor ta pimë nga një bozë.Porositi nga një kile.Unë nxorra ta paguaj,por s'më la.Shyto kur nxorri një shuk me deviza.E shita tha atë vendin ku pëllitnin magarët ditave të pazarit.Ia pamë tha ne kaurrët hajrin kurbetit shqipëtar.të tre fëmijët i kam më tha në "vllast"Shumë bre Sulo më tregojnë…Shyto mua mu ndal boza në fyt.

-Sylo,autobusët dhe taksit plotë shkojnë e vinë.

-Shyto,pastaj më tha se "vllasti" së shpejti do të mbëledhi armët e pastaj alltanat e grave,"vllasti" mendon se shumë kemi.

-Po ti ç'bëre?!

-I thash mirë bre SHKAVELL e pastaj çdo të bëni?e ai mu përgjigj shkurt Shyto,shpirtin Sulo shpirtin.Ç'mendoni se ne do t'ua lejmë tokën Juve,pse keni deviza dhe do të bëheni "gazdallarë"në tokën tonë!

-Ika Shyto ika duke thënë:ush,ush,ush e ush se edhe ne jemi tamam si ti ush…???!!!

DR.RUMDUM HAXHI ADHAMUDHI

Varrimi ishte caktuar për në orën katërmbëdhjetë
por për disa probleme familjare e kishin shtyer edhe për një orë më vonë edhe ate me mendimin e ekspertve,se i vdekuri nuk do të qelbej.Ne sa arritëm u përshëndetëm me të afërmit,dhe mua mu afrua një person dhe më tha që të shkonim pas tij,aty afër nën një hije arre,ku ishin ca burra me peshë dhe në mesin e tyre edhe imami,që mbante një ligjeratë shumë interesante.Ne i përshëndetëm,edhe ata na përshëndetën,por më kjartë e dëgjuam fjalën e imamit kur tha "starakufumulla" e pastaj edhe ca fjalë që për ne ishin të panjohura.Ne u ulëm ai vazhdoi me ligjeratën,herë në politikë,herë folte për medicinë,herë për të vdekurit,e më tepër për dyzet ditët pas vdekjes së personit ,familja duhej të jepte shpërblim për lexim të ja-sinit,që Zoti të vdekurin ta shpërblente me Parajsë,apo siç i thonte ai me Xhelenet.

Dikush aty në afërsi pyeti,prej nga ishte imami dhe a ishte në rregull me trurin.Dikush i tha se ai është Dr.Rumdumi.E një tjetër tha sipas kësaj që dëgjojmë

duhej ti shtohet edhe mbiemri Adhamudh.E dikush tjetër tha se paska doktoruar me zërin e tij prej tellalli.E dikush tha:

-Kur thirrë ky për të vdekurin,tamam altoparlanti ushton,si zëri tellallit nëpër Sarajevë,dhe për ate ia kanë dhënë titullin Dr.

Pas atyre fjalëve që tha hamami,për lexim të Ja-sinsit, Mevludit dhe Hatmeve,reagoi një i ri dhe u bë një tollovi,por në atë moment dikush thirri hoxhën që ta lante të vdekurin,pasi ai që kishin caktuar nuk kishte dashur,pasi ai si i gjallë kishte qenë njeri jo besimtar,edhe pse edhe atij ia kishin ngjitur një emër,Sasësi e dikush tha Hafësi ka shitur Kur'an e Ja-sin dhe krejt të mirat e Kur'anit.

Kortezhi ishte i gjatë.Në mesin e tij,pak pas të vdekurit,si u futën dhe kur erdhën ne si pamë,por dikush tha se këta çallmaxhinjt lindin si këpurdhat pas shiut,si afrohet koha e varrimit ata i ke aty.Kur i pa djali i të vdekurit i u afrua një të afërmi dhe i tha që ta huazonte nja treqindë euro.

Sa mbuluan të vdekurin,imamllarët e rrethan varrin si ato Hienat Kërmën,as më pak e as më shumë,por njëzetekatër e në krye Dr.Rumdum Adhamudhi.Çdo njëri filloi të këndojë nga tre a katër fjalë me siguri nga Kur'ani.

Në atë moment arriti një veturë luksoze me regjistrim të Zvicrës.Dr.Rumdumi sa e pa i doli përpara,si dikur ata të policisë për të marrë hisen dhe

të dëgjonin ndonjë fjalë spiunimi,që ta ngushllonte për vdekjen e babait.Duke e marr ngrykë i namatisi diçka në vesh,por ai i tha:

-Unë s'kam çka të jap euro baba ka qenë me vëllanë e vogël.Atëhere Dr.Rumdumi ngadalë tha:

- -Mua mi jep pesëdhjetë të tjerëve nga njëzet,për shpirt të babait,që ti shpëtojë Xhehenemit.Kurse djali i vogël përdridhej si bolla në zjar,pasi i shkuan,afër katër rroga arsimi…

DËNIMI I MERITUAR

Shpejt u përhap lajmi se mëngjesin e asaj dite paska vdekur xha Sula njeriu më i respektuar dhe më i vobeti në fshat,pa asnjë trashigimtar për magarin dhe një copë arë te varrezat e fshatit.

Heret përpara shtëpisë së xha Sulës ishin grumbulluar shumë të moshuar,por edhe mjaftë të rinj.Pleqt filluan të grumbullonin të holla për thirrjen e sallit dhe qefinave,kurse të rinjt shkuan të hapnin varrin.

Lajmin e vdekjes së xha Sulës shpejt e kishin kuptuar edhe fshatrat për rreth.Prandaj edhe pa mos u thirrë salli në fshatin e vet,filloi të dëgjohet salli prej minareve të fshatrave të afërt.Xha Biti u dha shenjë të

dy imamve të fshatit që të thirrnin,por ata heshtën dhe pas ca minutave u zhdukën.Xha Biti tha burra unë do të thirrë sallin për Sulën e ndjer.Në atë moment një i ri që ndodhej aty si plumbi shkoi te xhamia hapi derën i lëshoi të katër altoparlantët edhe ate deri në fund dhe ia nisi

Katundar të respektuar sot ka ndërruar jetë xha Sula,varrimi do të bëhet në ora pesëmbëdhjetë,Zoti e rehatoft në botën e përhershme.

Në atë moment u thirrë sall edhe në fshatin e afërt të xha Sulës,duke lajmëruar për vdekjen e një të pasuri.

Kur u afrua koha e varrimit,asnjëri prej dy imamllarve të fshatit sishin prezent.Rolin e tyre e mori një plak i cili dikur kishte bërë pak mejtep.

Pas ca ditësh njërit prej imamllarve i vdes baba i cili po ashtu nuk kishte marrë pjesë në varrimin e xha Sulës.Sallin e kishin thirrur heret dhe kishin lajmëruar me telefona,por asnjë nga fshatarët skishin shkuar.Tërë natën xhenazen e kishin ruajtur të afërmit dhe dy imamllarët.

Fshatarët ishin ngujuar nëpër shtëptë e veta e shumica kishin shkuar nëpër ara edhe pse sishte kohë pune,të tjerët kishin shkuar në qytet edhe pse skishin pasur asnjë farë pune.

Pas ca ditësh djali i të vdekurit e takon xha Bitin,dhe i thotë

A smendon se edhe ti do të vdesish si baba im,dhe se askush s do të vijë në varrim.Xha Biti i përgjigjet unë do të vdes dhe do të më vijnë i tërë fshati,pasi unë s kam shkuar për para si ti dhe baba i juaj…

KURDISJA E VDEKJES

Pasi më lëshuan nga puna,u pajtova me vdekjen,por pranë tryezës së punës me penë në dorë,e jo me thasët e çimentos në krahë,siç dëshironte gjakëpirrësi-vëlla…?!

NDALIMI

Në vendin e punës,në kohën më të keqe të monizmit,shkau s'ma ndaloi leximin e gazetave shqipe,kurse tash në demokraci ato mi ndaloi një biznispamend shqipëtar…?!

SURROGATI

Një intelektual-torbesh,më pa se haja drekë në një ditë Ramazani dhe i nervozuar më tha:

-Zotëri i nderuar,a veç me emrin tënd Begzat mendon se je musliman i mirë?!Unë ia ktheva:

-Jo zotëri torbesh,por me vepra të mira,por jo me OSKËN tënde, gjuhën tënde amtare sllave dhe flamurin tënd diell që kurrë s' të ka ngrohur dhe kurrë s'do të ngrohi…?!

DËSHIRAT

Pak ditë përpara Vitit të Ri rrugëve të qytetit një gazetar i një televizioni lokal,intervistonte kalimtarët e rastit,për dëshirat që t'u sillte Viti i Ri!

Rastësisht në një rrugë të qytetit takoi edhe xha Bitin.Pasi e përshëndeti i tregoi se kush ishte, ia bëri edhe pyetjen si shumë kalimtarëve të tjerë.Pas pyetjes xha Biti u mbështet në bastum dhe me atë stilin e vet,ngadalë
dhe rrjedhshëm filloi ti përgjigjet pyetjes:
Unë tha boll kam jetuar,boll kam edhe parë,boll kam edhe para,pasi për çdo muaj më dërgojnë djemtë nga Amerika,Zvicra dhe Australia e largët.Por qyshkur kam një dëshirë dhe s'di a do të më realizohet
dikur?!Hë i tha gazetari,ta dëgjojmë xha Bit!Pastaj
xha Biti ia nisi:

-Ndoshta këtë vit do të më realizohet ajo ëndërr e kahmotshme,që edhe ne shqiptarët të kemi një televizion,por më të fortë se ky i maqedonëve dhe ju të jepni lajme që do ti dëgjojë e tërë bota,por jo vetëm në gjuhën shqipe,por edhe në gjuhë të huaja dhe të kuptojnë kush janë maqedonët e kush janë shqiptarët,se boll më na mbushën neve dhe tërë botën plotë rrena këta maqedonët.Unë më s'di ç'të them biro Zoti Ju ndihmoftë Juve se na e hëngrëm tonën…

SEKRETI I SHULES

Një farë Shulje para ca ditësh e tregoi sekretin,që gjertani shumë pak qytetarë të Maqedonisë e kishin ditur.Ai me shumë përgjegjësi tha se Greqia është ajo që e ruan Maqedoninë,pasi më shumë se gjysmën e kapitalit maqedon e posedojnë grekët,dhe se mbi gjysëm milion banorë grek jetojnë prej kapitalit të maqedonisë.Prej kësaj del e vërteta se pse Greqia dhe grekët se pranojnë emrin Maqedoni…?!

BETIMI

Ca pleq shqiptarë,ishin ulur në parkun e qytetit dhe bisedonin për politikën e ditës dhe hallet e tyre,dikur njëri i pyeti se a i kishin parë mbrëmë lajmet dhe se sa polic shqiptarë e kishin dhënë betimin për ruajtjen e integritetit teritorijal të shtetit Maqedon?!Njëri iu përgjegj:

-Ata mirë e dhanë betimin dhe ata do ta ruajnë integritetin teritorijal të Maqedonisë,por nuk dimë dhe ata vet nuk dinë dhe nuk janë të vetëdijshëm se sa do të munden ta ruajnë integritetin e vet nga shteti Maqedon dhe maqedonët…???!!!

MOSMARRËVESHTJA

Xha Biti pasi kishte arritur shumë vonë në Kërçovë dhe s'kishte gjetur asnjë gazetë në gjuhën shqipe,ai kishte blerë "dnevnikun"në gjuhë sllave.Aty kishte hasur në një MOSMARRËVESHTJE,në mes Daut Dautit dhe njëfarë sllavi Dr.Stojçevski.Edhe ate për shqiptarët,që jetojnë në Turqi.Xha Biti ishte nervozuar pak si tepër kur e kishte lexuar tekstin,edhe meqenëse nuk e zotëron mirë këtë gjuhë siç thotë ai, me përmasa lokale.

Xha Biti ishte nervozuar,pasi dikur vet prej një poeteshe turke kishte dëgjuar se në Turqi me regjistrimin e fundit ka të regjistruar tre milijon shqiptarë,por ai numër është edhe më i madh.Edhe meqenëse ai nuk u beson shumë grave,por asaj poeteshës i paska besuar se të njejtën e paska lexuar te libri i ish kryetarit të Bashkësisë Islame"PËR FE E ATDHE"1996.Ku vet ish kryetari tash i ndjer,Turgut Ozal i thotë z.Rexhepit,shihet edhe në fotografi,për të drejtat e Juaja llogaritni edhe në katër milijon shqiptarë që jetojnë aktualisht në Turqi.Pra të nderuar ky shkrim le të jetë një lehtësim për MOSMARRËVESHTJEN…

KOMANDANT SHPATI

Gjatë dorzimit të armëve"KORRJA E DOMOSDOSHME"KOMANDANT SHPATI e dorzoi REVOLEN pasi kurrë se ka dashur.Për gjestin e mirë një USHTARAK I LART BOTËROR si SHPËRBLIM i dhuroi një mini STINGER duke i uruar punë të mbarë në KRIJIMTARI…

DEVOTSHËRIA-SHPIFJE

Para ca ditësh z.Rrugova duhej të bënte një vizitë në Hag.Pas një bisede me z.Ço-viç,ai ia merr pasaportën,duke u habitur për njëfarë DEVOTSHMËRIE.Rrugovën ca net se merrte gjumi,prandaj ai e kapi receptorin dhe bisedoi me zotin e dikurshëm edhe ate disa minuta.Harxhimet shkuan në kurriz të Kosovës,kurse krejt biseda në dëm të shqiptarëve…???!!!

GJETKËZA

Ai miku i madh i Tajvanit kur pa se krejt KARRIERËN POLITIKE e paska dështim,vendosi ditët që i kanë ngelur ti kalojë në GJETKËZ.Këtë e bënë,që të arrijë RAKORD NË MAJMËRI,që të regjistrohet në LIBRIN E GJINISIT,edhe ate për çdo ditë nga dy kilogram,por kur peshohej në mbrëmje,peshorja tregonte se ka humbur katër kilogram.Në konsultim me njerëz kompetent të shëndetit ata e zbuluan shkaktarin.Ai na paska qenë

pse punët nuk i kanë shkuar mbarë kundër SHQIPTARËVE…?!

REFERENDUMI

Nëse Parlamentarët Maqedon votojnë për Referendumin,atëhere Parlamentin,Qeverinë dhe tërë shtetin do ta shpallin si shtet-BURRECASH-pasi me sjelljen e tyre jo SERIOZË ata TERRORIZOJNË TËRË BOTËN…???!!!

MIKU I MIKUT TË TAJVANIT

Një mik, i atij mikut të Tajvanit, kur e kishte lexuar në gazetën « Flaka », tregimin « Gjetkëza », e ndal autorin dhe i thotë :

-Ti nuk i kupton punët dhe njerëzit e mirë. Ai miku i Tajvanit është mik dhe adhurues i flaktë i shqiptarëve. Ai ka hëngër e ka pirë nëpër shumë shtëpia shqiptarësh,bile edhe te një shtëpi e një Rumdumi, që ne na vjen keq që shumë shpejt vdiq dhe se mori epitetin e merituar?! Atëherë autori thotë:

- Shumë me vlerë do të jetë ai epitet, për të cilin Ju mendoni pas vdekjes se sa Rumdumët të tjerë për s’të gjalli?! Në atë moment vinë ca shokë dhe biseda u

ngel përgjysëm, kurse ai miku i atij mikut dhe i Tajvanit ka vazhduar me vetminë në Gjetkëz, duke bërë plane shfarosëse për mikun dhe kombin e mikut.

Një ditë kur ai mendoi se arriti gjer te zbulimi, u qetësua dhe ra të bënte një gjumë të rehatshëm. Shumë shpejt e kapi një gjumë i thellë, sa edhe vetë thellësia e tij prej intelektuali dhe kocmopoliti. Rrethë e rrotull kishte shumë dashamirë, në mesin e tyre edhe shumë dashamirë të elitës shqiptare. Këndoheshin këngë dhe hiqej valle komitash. I sollën një KALË me SHALË TË ARTË. E kapën katër veta dhe e hipën mbi kalë. Kali azgan ai bëhej edhe më azgan. Dashamirët i trokitnin, por më shumë Dr.Rumdumat.

Të gëzuar morën rrugën e gjatë. Arritën në Kërçovë, me valle e këngë trimash i pritën mendimtarët e tyre. Azgani si axgan dha shenjë për të vazhduar rrugën, që të arritnin sa më shpejt u futën nëpër tunelin e QIROS së dikurshëm, aty hasën në një katrahurë të papërshkruar. Pak përpara se të dilnin prej tunelit, dikush i afruhet dhe i thotë:

- Unë të flas në emër të Pavellit, edhe pak dhe do të arrini ta shikoni Drinin, por në këtë anë është adet, ata që të shëtisin me kësi kali ua presin K...Atëherë azgani i mbush brekët me shumë dashamirë dhe azgana.

Prej asaj ëndërre ai u bë armiku numër një dhe më i tërbuari për DECENTRALIZIMIN...? Kurse miqtë e mikut të Tajvanit e kanë lavarur kokën...?

AMANETI PËRHERSHËM

Më vjen keq,që mua më ra shorti të lajmërojë për këtë lajm të hidhur.I dashuri ynë BABA,ca ditë ndodhet në KOMË dhe në bisedë me kolegët tonë mjekë dhe atyre botërorë,shpresat janë zero.Atëhere njëri nga gazetarët e shumtë,shprehu dëshirën,që të hyrte në dhomën e BABAIT të kombit dhe ti bënte ca pyetje,por mjeku i tha se ajo ishte e pamundur dhe një dëshirë qesharake.Gazetari nguli këmbë si gomari në mes të urës.Atëhere mjeku u tha që të pritnin ca minuta të konsultohej me kolegët.Nuk shkuan shumë minuta ai e thirri gazetarin,që të hyrte te BABAI.

Gazetari i bëri disa pyetje,por ai s'jepte shenja jete.Më në fund i tha:

-Baba na e le AMANETIN E FUNDIT!Atëhere i hapi sytë shikoi në të katër anët e dhomës dhe tha:

-Toka E SHENJTË MAQEDONE s' do të më kalbi nese ju lejoni sa të jetë bota,që në krye të shtetit Maqedon të vijë një SHQIPTAR,i mbylli sytë dhe iu shua jeta…???!!!

JO FINANSIM

Një damë e rëndë në pleqëri të thellë dhe me titull të lartë shkencor,nëpërmes të valëve të një radio stacioni lokal maqedon tha:

-Jam kundër dhe urdhëroj Qeverinë e Maqedonisë,që të mos bëjë finansimin e asnjë gjuhe që flitet në këtë shtet,përveç asaj Shtetrore-akcentojë VETËM GJUHËN MAQEDONE.Nëse bëhet finansimi i gjuhëve të tjera siç janë bërë gjertani,e veçanrisht i GJUHËS SHQIPE,atëhere GJUHA MAQEDONE do të VDESI e me te edhe NE MAQEDONËT.Pra dama PARAZITIZMIN,PA AFTËSIN për GARA dhe NACINALIZMIN e PAKONTROLLUAR deshiron ta lejë TRASHIGIM…???!!!

TJERRJA HOLLË-HOLLË

Një farë Buçkoje duke i dëgjuar lajmet e Radio Shkupit,që vinin nga Tetova prej një gazetari me emrin JO-HANËMUT BUBËRRESKI,që me aq OREKS i thotë fjalët:banda kaçake dhe se ballistët bëjnë rrënime në këto anë.Përveç tij këto banda i përmend edhe një “HISTORIAN”,por ato të kohës së L.N.Ç,atëhere kur MEFAILI I VOGËL i dërgon një

letër duke i raportuar shokut MEHMET SHEHU,për luftën dhe duket se i ka kërkuar njëfarë ndihme.Atëhere shoku pro sllav,paska përdorur fjalorin e këtij JO-HANMUTI,për bandat Balliste,dhe thotë se nëse duhet të dërgohen ndihma atëhere do të dërgojmë për "VËLLEZËRIT SLLAV",prej kësaj shikohet se edhe shoku Mehmed me shokun Hoxhë,ska mundur ti dallojë,qëllimet e ballistëve të Shqipërisë dhe të ballistëve në tokat e okupuara nga sllavët.

Buçkoja kur i dëgjon këto fjalë dhe i analizon mirë merr rrugën drejt te Pandeli vëlla për nga feja.Tirana e Pandeli Ortodoks,por me zemër e shpirt Shqiptari,tamam si PAPAKRISTOT,i paskan tjerrur mirë e HOLLË-HOLLË "vëllezërit-sllavomaqedon",le që si pranuan si vëllezër,por as si kojshi.Pasi u kthye nga Tirana Buçkoja tha:

-Edhe në këtë dasëm nusja u dhi …???!!!

NUSJA NAIVE

Para ca ditësh ishin hapur dyrt Ferrit dhe të Parajsës,në atë tollovi ne prej turmës s' kuptuam shkakun e hapjes,por kuptuam dhe pamë pse njerëzit e atjeshëm ishin grumbulluar në turma dhe ate të konfesioneve të ndryshëm,po ashtu të kombeve bile edhe të ngjyrave të ndryshme.Ata çmalleshin me njëri

tjetrin,tregonin për dënimet dhe shpërblimet e sjellura prej atje,sipas veprave të bëra.

Në një skaj vërejtëm disa ish kryetar të ish Jusë,me në krye atë efo Tejton,që I mësoi shumë pasardhës për "Vëllazërim Bashkim"(ashtu e thirrnin në atë kohë efo Tejton nga ana e liderit tone të madh)bile disa edhe sot e kësaj dite mundohen për asi fare jetese.Njëri I tha efo Tejtos se kishin qenë shumë të lumtur dhe me shumë sukses u kishte shkuar politika,kur ata "shiptarite"kishin qenë "naiva"tamam si ajo Nusja e Bukur e martuar për HOXHËN plak,por shumë të pasur dhe dinak.Një ditë kur ajo bisedon dhe meson(siç mësojnë tash shqiptarët)nga ajo plaka e vendosur në afërsi të kryqit në LAGËSHTIRË,se ajo punë nuk bëhet siç i thot hoxhë dinak mëkatari,por shumë më ndryshe,tamam siç dinë tash edhe shqiptarët:për fjalën,komb,flamur,gjuhë,histori dhe…Hoxha pësoi,por më shumë pësojnë këta tonët,prej atyre që ky liderri,që sot është me ne dhe kishte thënë se po të ishte pak më i ri edhe ai do të kishte dalur në mal,por atij i paska ardhur mirë se ata edhe pa te i paskan dalur në fund punës me shumë sukses,por ata të pa prerit ia paskan marrë fytyrën,siç duan t'ia marrin futyrën edhe këtij liderit tonë,të maleve,ata kur e humbin luftën me armë me shumë mjeshtri dhe dredhi mundohen ta fitojnë dhe e fitojnë në tavolinë,ashtu siç na mashtruan edhe neve.

Tash shqiptarët,tamam si nusja kërkojnë,që çdo punë të bët ashtu siç duhet dhe siç shkruhet në niqaf,marrëveshje dhe…

STARAFUKUMULLAH

Varrimi ishte caktuar për në ora katërmbëdhjetë,por për disa shkaqe familjare e kishin shtyer për një orë më vonë,edhe ate me leje të ekspertve se kufoma nuk do të qelbej.Ne sa arritëm,u takuam me të afërmit ,dhe në atë moment na u afrua një person dhe na tha që të shkonim pas tij,atje nën hijen e trashë të një arre.Pastaj na tha se atje paska ca burra me peshë,por jo si ata që dikur u thonte xhaka Dul për ata të …dhe se në mesin e tyre qenka edhe Imam Rrumdumi dhe se mban një ligjeratë shumë interesante.Në atë moment ne arritëm te hija e trashë i përshëndetëm,por edhe ata na përshëndetën,pasi u ulëm dëgjuam fjalën e Rrumdumit "stafarakumullah"dhe ca fjalë të tjera aspak të kuptuara për ne,por edhe për shumë të tjerë.Pastaj ia filloi ligjeratës,here në politikë,here në medicine,por më tepër për ata dyzet ditët e pas vdekjes së personit,familja duhej të kujdesej me dhënjen e shpërblimeve pë lexim të Ja-sinit dhe të një hatmeje që Zoti të vdekurin ta shpërblejë me Parajsë edhe nëse ai ka bërë mëkate.

Dikush aty afër pyeti nga ishte imami,dhe se a është në rregull me trurin?!Dikush i tha hesht se ky është ai Dr.Rrumdumi.Dikush aty afër tha, se prej asaj që dëgjon duhej ti jepet edhe epiteti Adhamudh.Dikush tha që të heshtin se atij ia paskan dhënë të gjitha titujt për zërin e tij unikat për thirrje të SALLIT,kur thirr ai ushton qyteti,tamam si tellalli nërpër Sarajevë.

"Doktori"vazhdonte me vaizin,por tash më doli në kapitull tjetër,filloi të foli për Mevludin,por prap i përzinte me Ja-sinin dhe Hatmet,që as drejqi smundej ti binte në fije.Në atë moment një i ri reagoi aq ashpër,sa u bë një tollovi,që kush din se ku do të dilte dhe çdo të ndodhte pot të mos e thirrnin hoxhën që ta lante e pastronte të vdekurin,pasi ate që e kishin caktuar,ai s' kishte dashur pasi i vdekuri edhe pse kishte pasur një titull fetar,apo siç e kishin thirrur HAJSËS,apo dikush afës ai e paska keqpërdorur shkrolën e Zotit dhe të Kur'anit.

Kortezhi ishte i gjatë.Në mesin e tij,pak pas të vdekurit,si ishin futur dhe kur askush s' dinte të thotë gjë.Por dikush tha se ÇALLMAXHINJTË si afrohet koha e varrimit lindin si këpurdhat pas shiut.Kur i pa djali i të vdekurit,iu afrua një shoku dhe i that ta huazonte nja treqind euro.

Sa e mbuluam të vdekurin,imamllarët e rrethan varrin si ata HIENAT KËRMËN,kurse numri i tyre arriti tamam njëzetekatër me në krye Dr.Rrumdum më

Adhamudhin.Çdo njëri filloi të lexonte nga disa vargje të Ajeteve Kur'anore.Në ato momente,pamë një limuzinë luksoze me targa të Zvicrës,Dr.Rrumdumi sa çel e mëshel sytë si shigjeta e la turmën dhe i doli përpara si ata policët si dikur për ti marrë pasaportën.Kur u afruan afër nesh filloi ti namatiste ca fjalë në vesh,por ai ia ktheu se baba paska qenë me vëllan e vogël dhe ai s'ka pse të japi euro.Dr.Rrumdumi duke iu përkulur i tha për të shpëtuar shpirtin e babit.Dhe se për një kurbetli s'janë shumë,pesëdhjetë për Dr.Rrumdumin e për të tjerët nga njëzet euro.

Kurse djali i vogël përdridhej si bolla në zjarr,pasi për imamllarët duhej të paguante as më pak e as më shumë katër rroga të veta prej arsimtari…?!

HUNDË LESHI

Ca gazetarë maqedon të një televizioni lokal,rrugëve të Kërçovës panë një burrë të veshur me tirçë,struke e kësulë të bardhë,me qëllim që të argëtohen vetë dhe shikuesit e vet,iu afruan dhe e pyetën:

-Zotëri,JU lutemi të na thoni mendimin e juaj për shtetitn tonë-Maqedoni?!Ai si e kuptoi mirë

pyetjen prej shokut,që e shoqëronte-pasi se kuptonte mirë maqedonishten,u mendua pak dhe ia filloi:

-Dikush dëshiron apo jo ky shtet,pasi ju thatë se është shtet,unë do të them se është një "MINI JUGOSLLAVI",dhe se ju maqedonët,nëse jeni silleni tamam si ata të Millosheviqit,ç'është më e keqja edhe Çeveritë e më parshme,por edhe kjo e pas luftës,i tha shokut tregohu ti se unë jam prej Zajazi dhe se kam parë disa lufta,por edhe disa Jugosllavia e Maçedonija.Edhe njëherë Ju them Juve, se nëse su mbushet koka me mend,do të vijë ndonjë burrë si unë "HUNDË LESH"e atëhere vaj me det për këtë shtet…

ZBULIMI I SHEKULLIT

Xha Biti sa arriti në qytet,shpejt e shpejt i vizitoi të gjitha zyrat për informim dhe për në ora katërmbëdhjetë caktoi edhe konferencën.Fiks në atë kohë,në sallën e madhe të Pallatit të Kulturës,ishin gazetarët dhe shumë qytetarë rasti.Xha Biti pa humbur kohë,pasi duhej të kthehej në fshat,e më vonë s'do të kishte autobus,por duhej të paguante taxi,ia nisi me atë stilin e tij:

-Gazetar të nderuar,unë ka një kohë bukur të gjatë,që s'mundem të flejë rehat,prej mendimeve të

shumta,në këtë kohë të pa kohë.Por para ca ditësh iu futa një studimi dhe mendoj se ia kam arritur qëllimit dhe zbulimit.

Gjersa P.D.SH-ëja ishte në pozitë,ai lideri i saj folte aq ngadalë dhe me aq mundim sa që shumkush prej jush,por edhe unë mendonim dhe pritnim kurrë do të thirrte hoxha-Dr.Rumdum Adhamudhi atë sallin e doktoraturës.

Kurse ai njeriu i maleve,në atë kohë folte ashtu si gjëmonin edhe armët.Por tani kur i ndërruan vendet njëri në Pozitë e tjetri në Opozitë,i pari flet si dyti,kurse i dyti flet si i pari.Prandaj gazetarë të nderuar unë u kam thirrur,që të shpallë ZBULIMIN E SHEKULLIT dhe SËMUNDJEN SHQIPTARE,kur shqiptarët janë ORTAKË me shkavin,kanë punuar,punojnë dhe duket se do të punojnë në dëm të vetëvetes…?!

“ TRADHTARI KOMBIT “

Para ca vitesh një far patrioti nga perendimi,pas një sateliti,dërgoi një haber,e në te isha përfëshirë edhe unë si “tradhëtar i kombit”.U habita,por edhe shumë të tjerë u habitën për lajmin e

çuditshëm.Vendosa të takohem me satelitin,që të më sqaronte a ishte ajo e saktë,që dikush e përhapi ate haber.
Sateliti si satelit,tha se ai që ta ka shpallur lajmin është i vërtetë,por edhe ai ka dorë në ate notim për ty.U habita,por sia vura shumë veshin.Por ajo që ma thanë të dy se paskam vëlla,ate që s'mundem ta mohoj se ma ka bërë edhe nëna edhe baba,por pse unë s'kam mundur ta vërej tërë jetës,vëllau i im qenka "tradhëtar i kombit",akuzë shumë e rëndë,por edhe më e rëndë,për mua.Por kur kuptova se ata janë Marksista-Leninista,dhe se në shpirt e zemër kanë xhaxhin Enver,disi e kurajoja vetveten.

Dikur këtë haber ia tregova vëllaut.Ai u habit dhe më tha:

-Unë ata njerëz të policisë,i kam shokë kafeneje edhe ate vetëm par ashtu siç u thoni Ju të mësuarit,për punë të pushtave,betohem se kurrë s'kemi biseduar për punë të politikës.Por në atë kohë kur ai farë patrioti që i thua ti ishte këtu me ne,shokët e mi ai i kishte më shumë të dashur se sa i kisha unë.Sa e sa herë ai vinte nëpër ato kafene,ku shkonim ne,uleshte në një tavolinë vetë dhe shokët e mi shkonin te ai,bisedonin ca minuta dhe pastaj ktheheshin në tavolinën tonë,por mua ajo as që më interesonte.Në atë kohë ishte në modë,shqiptarëve që vinin nga perendimi tu mirrej pasaparta,dhe si unë ashtu edhe ju keni dëgjuar se jepnin nga disa mijë marka,që tu

kthehet pasaporta.Prap unë betohem,se kurrë s'më kanë interesuar edhe këto punë të fëlliqta.Vëlla,do ta tregojë koha,si të mirën ashtu edhe të keqen,unë s'mërzitem për kësi marrinash…

Pas ca vitesh filluan të jepen dosjet,dorën në zemër,unë pritja që vëllau të jetë i regjistruar në shumë dosje,por ndodhi e kundërta,i morrën me qindra persona,por aty paraqiteshin,ata që ne e vëdonim dorë në zjarr dhe me ta kishim biseduar si me veveten,por na doli ndryshe.

Para ca ditësh,vëllau më kërkoi në telefon dhe më pyeti a i kam lexuar gazetat,pasi ai heret shkon në punë.Unë i thash, se tash sa kam larë faqet dhe se pres të pijë kafen e mëngjesit.Nuk shkuan as dhjetë minuta erdhi vëllau me disa gazeta në dorë.Sa u ul më tha:

-A mban në mend se ç'më ke thënë dikur,për atë fare patrioti,por a mban në mend se edhe unë ç'tu përgjigja.Dorën në zemër,s'dija ç'ti them,përveç asaj se i mbaj në mend krejt ç'kemi biseduar.Më tha na gazetat dhe lexo për atë farë patrioti sot folë i tërë qyteti.Ja ky ish krye polici jonë i kërkon duel përpara ekraneve dhe ti hapin letrat,por jo vetëm pesëdhjetedy letra,por të njëqindekatërtat dhe të shohi popullata se nësa montime atentatesh është i përzier ai farë patrioti…

MOS KTHENI PRAPANICËN

Sa e dëgjova fjalën alo,kuptova se andej është xha Biti.Ai si përherë,s'bënë shumë fjalë nëpërmes të telefonit.Më tha:

-Unë jam duke pirë bozë te xha Murati,po të duash dhe ke kohë eja.Po,apo jo.Unë edhe pse isha i lodhur,s'mundesha të them jo.

Xha Biti vërtetë pinte bozë,por përpara kishte edhe një pjatë të mbushur me plotë ëmbëlsira.Ia filluam bisedës,por edhe hanim e pinim bozë,që rrallë kush e bënë si xha Murati.Xha Biti,pas shumë pyetjesh më pyeti,edhe pyetjen se kur kam qenë në kryeqendër,dhe si kisha kaluar dhe ç'kisha parë.Unë as që i vura vesh asaj pyetje,por xha Biti nguli këmbë dhe disa herë sillej e mbështillej rreth saj.Më në fund më tha se e kisha hidhëruar atë ish policin e Millosheviqit,që dikur te restorant "ELITA",na bindte se në kohën kur Serbia ishte në Kosovë ishte më mirë situata se tani kur asaj ia shkulën rrënjët prej Kosove.Por ne reaguam ashtu siç dinim e mundëm.Prej asaj dite pak i kemi të acaruara punët.Atëhere mu kujtua se kur isha në kryeqendër,në një rrugë të Bit Pazarit,prej larg u pamë me ish policin,por kur u afruam,ai u ndal përpara një shitorje dhe filloi të shikojë,mallin e ekspozur si ata

sheherlinkat,pas mesnate,kurse nga unë ktheu PRAPANICËN.Unë kalova sikur se pash,por atij i paska rënduar ajo sjellje.Dhe kur është takuar me xha Bitin,i është ankuar.

Si ia sqarova xha Bitit si ka qenë e vërteta,ai më tha se ate,e bënë me të tërë dhe se paska qejf,njerëzit ti afrohen ta përshëndesin,ti përkulen,ti japin ndonjë pije dhe atëhere ai arsyetohet se është i zënë dhe shumë i lodhur prej punëve.

Xha Biti pasi kuptoi se si paska qenë puna,tha ta lejmë më ish policin e Millosheviçit,të bisedojmë për hallet tona.Kurse unë i thash:

-Xha Bit Ju vet më keni thënë,se njerëzit i njehë,prej fytyrës e jo prej PRAPANICËS,e ndoshta ai polici është si Martinoviçi…?!

NËMA SHQIPTARE

Në konferencën me gazetarë që e thirri dikur xha Biti,si pyetje e fundit nga një gazetar ishte:

-Xha Bit,ç'mendoni për papunësinë në Maqedoni dhe për largimin e shumë puntorëve nga viset e punës?!Xha Biti u pëgjegj shumë shpejt dhe shumë shkurt:

-Maqedoninë dhe maqedonët i ka zënë NËMA SHQIPTARE.Dikur fëmijët tanë i largonin nga puna edhe për ëndërrat e pa ëndërruara.Në mëngjes shkonin në punë,por shumë herë ndodhte që ata të mos ktheheshin në mbrëmje në shtëpi,por drejt e në burg.Ne s'kishim forcë tjetër vetëm të NËMNIM si nëpër dru ashtu edhe nëpër gurë.Fëmijët tanë i largonin nga një, dy, tre,katër…,kurse këta i largojnë si me bulduzer dhe Organizatës Punuese i vëndojnë dryrin.Por le të jenë të kënaqur,që këta nuk i mbyllin nëpër kazamate,unë ato NËMË i kam dëgjuar me këto veshë,por tani i shohë me këto sy plaku…

AKADEMIA SHKENCORE

Përpara ca kohe në qytetin Singidinum,në një Akademi Shkencore ishin mbëledhur shumë shkencëtarë të shtetetve Ballkanike,me qëllim që të vinin deri te vërteta shkencore,për prejardhjen e fjalëve të emrave të shteteve të tyre.
Mbëledhja ishte e hapur si për gazetarë ashtu edhe për njerëz kurioz.Në atë kohë në Singidinum kishte qenë edhe xha Biti dhe duke ecur rrugëve të qytetit,që dikur ka punuar dhe ka bërë avantura.Këte e them se vet më tregoi se pas pesëdhjetë vjetësh e paska thirrë djali me

gruan e katërt,që e ka pasur në atë vend.Pra siç thuhet në popull gjaku ujë s'bëhet,por ne nuk do të ndalemi te aventurat e xha Bitit.Ai si i sheh lajmërimet dhe qëllimet e asaj Akademie,shkon drej e në sallë.Pasi dëgjon shumë biseda dhe më ata shteren,për emrin Serbi,por pa ndonjë përfundim shkencor.Dikush prej atyre që kryesonte pyeti publikun,ndoshta kishte ndonjë që do të jepte ndonjë mendim më të sakt.Atëhere xha Bitit në mendje i vinë bisedimet që ka bërë dhe dëgjuar në atë vend,për atë vend.Dhe e merr fjalën,unë në atë moment e lëshova televizorin,dhe iu afrova më afër duke mos u besuar syve.Xha Biti në Singidinum,ashtu me ata tërqët,xhamadanin,struken,këmbësën e bardhë dhe atë shaminë e kuqe që e mban përherë rreth qafe.Pasi i tha ca fjalë dikush nga gazetarët e pyeti:

-Sa gra i keni pasur or plakush,ndoshta edhe i keni?!Xha Bitit pa mos iu trembur syri ia filloi përgjigjes:

-E para më ka vdekur,prej tifuzit.Të dytën e kam mbytur në bunar,të tretën e kam varur në litar e katra që e kam pasur këtu dhe më ka thirrur djali,shpejt paska vdekur,prej frigës nga bombardimet e NATO-s.E pesta shkoi dikur në Amerikë te djali dhe akoma s'është kthyer,prandaj unë e mora edhe të gjashtën,por ajo shpejt më vdiq.Tash kam një në shtëpi,sa për nevojat e burrit.Dikush tjetër nga gazetarët e pyeti:

-Sa fëmijë i keni or plakush?!Xha Biti pak u mendua tha tha:

-Me të gjitha gratë katërmbëdhjetë,dhe të gjitha meshkuj,dhe të pushkës.

Mos largohemi shumë nga tema tha xha Biti.Mua aspak nuk më bindët me tezat e juaja për emrin Serbi.Unë do të tregoj çka kam dëgjuar prej njerëzish të juaj,në atë kohë kur kam jetuar në këtë qytet.Ata paskan dëgjuar prej baballarëve të baballarëve të baballarëve…Se dikur në këtë vend pakan ardhur shumë njerëz,prej andej nga Karpatet e Egra,për të nxjerrë kafshatën e bukës.Njëri i cili ka punuar në një pronë të një shqiptari edhe ate këtu në Singidinum e ju si e thirrni është punë e juaj,unë s'do të përzihem.I sëmuret një terak dhe pasi e viziton një plak i cili ka pasur shumë dijeni për sëmundje të kafshëve,i jep ca barna dhe i porosit,që ta ruajnë për një orë a do ta bëjë shurrën dhe bajgat.Ai i cili nuk e ka dijtur gjuhën shqipe sa e sheh se teraku i bënë bajgat,fillon të bërtasi:SEREBIK,SEREBIK…Dhe ashtu ati i jeti emri SEREBIK.Kur pyetnin kush është ai,thonin SEREBIK,ku shkoni te SEREBIKU.Ai dikur u martua,bëri dasëm,ata që shkuan,thonin se shkojmë në dasëm te SEREBIKU.Lindi fëmijë,u thonin fëmijët e SEREBIKUT.Shumë,shumë vonë ia paskan hekur atë germën E dhe në fund K-ën.Unë zotërinjë të nderuar,e thash ate që kam dëgjuar dhe kam dijtur për emrin e shtetit të juaj,e ju kuptonim si të doni,ju

faleminderit që më dëgjaut.Të gjithë e përshëdetën me apllaus.Pasi mbaroi mbëledhja shkencore u bënë edhe konsultimet dhe në fund u pruan edhe vendimet.Të gjitha ata që kishin diskutuar i thirrën në darkën solemne dhe në mesin e tyre edhe xha Bitin.Aty u shpall edhe mendimi dhe teza më e sakt për shtetin SERBI.Si më e saktë doli teza e xha Bitit,ku aty e nderuan me HONORIS CAUSA…

DR. KALOSHOLOGU

Pasi i sigurova katërmijë marka gjermane vendosa të bëhem HAXHI.Mirpo një natë mu përhirë në ëndërr një njeri,jo më falni s'ishte njeri e më tha:

-Ty s'do të bëhet KABULL haxhillëku,ti e din se je më matrapazi i matrapazëve në qytet.Ti mundesh të bëhesh një Dr.bile shumë,shumë i madh.

Fillova të lexoj libra e libra,gazeta e revista,e më në fund edhe ZEKTHIN,që ka filluar të dali para një kohe dhe del kur ti teket.

Pasi rash vonë,se lexoja siç thash më lart,e ajo krijesa prap mu paraqit në ëndërr,e më tha:

-Tash më je pjekur dhe din,çka duhej bërë.Unë i thash duhej vazhduar me lexime dhe punë e vetëm punë.E ai qeshi e më tha:

-Tash duhej të bëhesh dhe do të bëhesh një Dr,dhe më e din se për cilin?!Unë i thash:jo!Ai qeshi e më tha:

-Ti do të bëhesh një Dr.KALOSHOLOG edhe ate shumë i MADH,por tani shpejto,se ndoshta dikush i ka përveshur duart dhe…

Mua më vajti mendja te ata shkrimtarët e mjerë të cilët kur ishin të gjallë,shkruanin natë e ditë dhe botonin nëpër shumë gazeta e revista,por përherë barkun e mbanin me dorë.Dhe se përherë ishin të nënçmuar,bile edhe të maltretuar,tamam si këta të kohës sime.

Në disedë me zotin Kalosh,ai më tha se ajo është punë e imja,por kur ia sqarova,se bëhej fjalë për titull edhe ate Dr.dhe se pas titullit do të kesha shumë autoritet.Gazetarët dhe televizionet s'do të më lejnë rehat,ndoshta dikush thotë të bëhem edhe ministër apo deputet e të mos folë për redaktor revistash,ose profesor në këta Universitetet tona.Atëhere i thash zoti Kalosh do të jetoj tamam si "MINISTËR"siç thotë zoti BUXHA.

Ti zoti Kalosh je i gjallë dhe më duket se do të kapi inati,pasi unë pa asnjë vepër,por me veprat tuaja do të bëhem Dr.kurse ti Kalosh bile edhe Çeliku me një vagon libra por më pak se baca Salë s'ke mundur

të sigurosh asnjë titull.Le ta marri drejqi të kishe barem MAGJISTËR.Ç'është më e keqja ti zoti Kalosh s'ke as punë,jo më falë ti punë ke,por ajo s'paguhet.Atëhere zoti Kaloshi më shikoi e më tha:

-Kjo s'prish punë,pasi unë si pranoj ata Drrr-a dhe ata nuk janë marrë me krijimtari,por me KRIM-TARI.Unë jam i vetëdijshëm për ate,dhe se jeta është e poshtër,ja një shembull:pula e bënë venë dhe si shpërblim merr një kokërr gërtuk,kurse ai tregtari e shet venë e pulës dhe fiton njëqind kokrra gërtuku.Bile edhe ai shkencëtari thotë se ne shkrimtarët dhe poetët s'bëjmë punë të dobishme dhe ai më shumë i çmon këpuctarët se sa neve,por i mjeri nuk dinë se zbulimet e tij dhe shumë të tjerëve janë për shkarërrimin e njerëzimit…Ti zotëri vazhdo dhe u bëfsh me shumë tituj Drrr-ash…